

Skriningu
Gjyqësia, e para nën thjerrzën e BE-së

Fq.4




MUNGESA E STRATEGJISË
Paralele me tre nxënës në shkollat profesionale

Fq.4



Zendeli, shkupjani që synon Formula 1

Fq.19



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3430 · e martë, 7 gusht 2018

21°C | 30°C

15 DEN



KOHA për kulturë

Fq.12-13

FORUM

Prelud:
Shiptari, albanci, apo shqiptarë!?



Ne vazhdojmë të jemi dy botë të ndryshme, maqedonasit e shqiptarët, ose më saktë ne do vazhdojmë të jemi në këso taboresh ndryshse sepse kemi trashëgimi kulturore dhe formësimi të ndryshëm. O loçk, s'ka send të keq këtu a, gjithandej... Fq.10

RAJON

Të përkrahet marrëveshja
Thaçi-Vuçiq

Fq.16

GLOBI

Gjermani, çdo i katërti i huaj

Fq.17

GLOBI

Çfarë e lidh Turqinë me Evropën?

Fq.17



NË PRITJETË EUFORISË "PRO" APO "KUNDËR" REFERENDUMIT

ÇELËSI TE PËRKRAHJA NDËRKOMBËTARE



VMRO ende nuk ka qëndrim zyrtar për bojkot të Referendumit, por kundërshton ashpër Marrëveshjen për emrin me Greqinë. Të lidhur direkt apo indirekt me VMRO-në, një sërë organizatash dhe parti të vogla politike, prej tyre njëra me orientim prorus, mbajnë qëndrime radikale kundër Referendumit. Me interes po priten jo vetëm qëndrimet zyrtare të bashkësisë ndërkombëtare, por edhe veprimet e saj diplomatike përfshirë dhe kanalet interne, që të ndihmojnë pushtetin për kalimin me sukses të 30 shtatorit Fq.3

Vijnë, premtojnë dhe nuk realizojnë

Tetovë, 6 gusht - Tre vite më parë, kur disa vendbanime të Tetovës ishin përfshirë nga vërshimet që morën me vete edhe viktima në njerëz, autoritetet qendrore dhe ato lokale nuk gjetën mënyrë për të parandaluar vërshime dhe përmbytje të reja. Pikërisht tre vite më pas, në fshatin Poroj sërish kishte frikë që situata të del jashtë kontrollit. Sipas një retrospektive, në këtë fshat pothuajse nuk ka ngelur pa

ardhur asnjë funksionarë më i lartë shtetërorë në nivel kryeministrash. Ish-kryeministri Nikola Gruevski dikur kishte paralajmëruar se do të sanohen dëmet dhe do të intervenohet që situata të këtilla të mos përsëriten. Po ashtu, në vitin 2017 në këtë fshat kishte ardhur edhe kryeministri i ri Zoran Zaev, për të parë nga afër vërshimet duke premtuar se Qeveria është në dispozicion që të ndihmojë... Fq.9



EDITORIAL

E ARDHMJA PËRTEJ TRIUMFIT PARTIAK



Emin AZEMI

Ethet parareferendumiane në Maqedoni, kanë burime të ndryshme kurimi. Një virus rus që po shëtit nëpër Shkup dhe në qytete tjera, po mundohet të motivojë lëngatën antieuropiane, duke nxitur defetizëm të një pjesë e qytetarëve.

Epilogu i refendimit në Maqedoni ka edhe rëndësi gjeopolitike. Topografët e sprovuar po mundohen t'i mbështjellin gërshtërit e tyre me harta të vjetra e të reja. Implikimet e jashtme historike po përkthehen si "interesime normale" për pjesët e ngelura të popujve në këtë shtet të kontestuar nga jashtë e të keqkuptuar nga brenda. Por, një është e sigurt: tërësia e këtij shteti, më tepër se kujtdo tjetër, iu konvenon shqiptarëve. Ky do të duhej të jetë edhe motivi kapital për të dalë në refendum dhe për t'i dhënë përgjigje pozitive anëtarësimit në NATO dhe BE. Marrëveshja me Greqinë është kushti, por edhe pa këtë kusht e ardhmja jonë është e varur nga integrimet euro-atlantike.

Gabimisht po interpretohet në qarqe të ndryshme se referendum i favorizon vetëm njërin palë, gjegjësisht palën maqedonase. Por, do të ishte iluzore që të presim mbylljen e të gjitha çështjeve të hapura me këtë referendum. Vetëm një çështje mund të ngelë e hapur, nëse shqiptarët e bojktojnë referendumin dhe ajo lidhet kryekëput me kontekstin gjeopolitik. Mund të tingëllojë disi naive se shqiptarët edhe kësaj radhe po e shpëtojnë Maqedoninë nga kaosi dhe shpërbërja, por shumë argumente janë në favor të tezës se një prej shtyllave kryesore që mbajnë në këmbë këtë shtet janë pikërisht shqiptarët.

Referendumi ka hapur shumë orekse antieuropiane dhe këtu shihet oaza e fundit në Ballkanin Prendimor ku mund të sprovohen ambicjet e reja dhe të vjetra për të rikthyer shanset e humbura të ndikimit dhe implikimit rus. Mund të duken marginale qelulat e tanishme të këtij implikimi, por ato ka rrezik të zmadhohen nëse vetëdija europiane e qytetarëve relativizohet nga thirrjet për mosdalje në referendum.

Shqiptarët nuk po e shpëtojnë Maqedoninë, por po e shpëtojnë vetveten nga një krijesë që fare lehtë mund të jetë pre e këtyre implikimeve. Dimensioni gjeopolitik i referendumit prek interes shqiptarë në Ballkan, sidomos tani kur në Beograd e Prishtinë flitet hapur për ripërkufizim të hartave shtetërore e etnike në mes të Kosovës e Serbisë. Vetëdija politike e shqiptarëve të Maqedonisë duhet të jetë disa nivele mbi intrigat e provokatorëve të ndryshëm që po bëhen kinse po punojnë për interesat e shqiptarëve. Në fakt, mbrojtës më të denjë të interesave të shqiptarëve, janë vetë shqiptarët dhe aletatet e tyre strategjik SHBA-të, kurse sjellja brenda normave europiane është përgjigja më e mirë ndaj atyre që duan një rifragmentim të qenies shqiptare në rajon.

Referendumi në Maqedoni është një nga ato sjellje europiane, të cilën shqiptarët duhet ta kuptojnë më tepër si proces se sa si teknikalitet zgjedhor. Është kjo faza kur pesha specifike e faktorit shqiptar nuk matet më me matematikën e thjeshtë elektorale të partive politike, por me vendosmërinë e një populli i cili përgjegjësinë e vet në momente vendimtare nuk e bazon mbi kontekste të ngushta partiake, por shkon përtej kësaj, duke nxjerrë si të domosdoshme të ardhmen e përbashkët që është më sublime se çfarëdo lloj triumfi partiak.

VETINGU TË NDIQET EDHE NË POLITIKË

"Ne po shohim se si njerëz të pushtetshëm dhe deri dhe të paprekshëm sot po largohen nga sistemi, dhe ky është lajm trefish i mirë. Sepse tregon se edhe në një mjedis kaq korruptiv si Shqipëria operacione të thella antikorruption si vetingu mund të funksionojnë, sepse jep mesazh për prurjet e reja në sistem që të jenë më profesionale dhe më të ndershëm dhe sepse jep shpresë se të njëjtin model do të ndjekim më pas edhe në politikë...."

Në procesin e deritanishëm të vetingut kemi te paktën katër përfundime të rëndësishme: e para, çdo reformë tani, sado problematike, është më e mirë sesa sistemi i korruptuar i drejtësisë që patëm para 2018; e dyta, ky është një eksperiment ndërkombëtar dhe si i tillë, do të zgjidhet/imponohet me presion ndërkombëtar duke pamundësuar konsensusin antireformë të partive të mëdha; e treta, rezultatet e vetingut do të jenë në çdo rast shumë larg pritshmërive publike, sidomos në kohë. Procesi do të zgjasë 8-11 vjet, dyfish më gjatë sesa politika u ka thënë qytetarëve. E fundit, në një shoqëri pa kulturë shtetërore e demokratike, të prirur nga lidhjet fisnore, krahinore dhe politike, sfida për shtet të së drejtës dhe pavarësi institucionesh është e mbetet sfida jo e muajve apo viteve, por e dekadave të ardhshme", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, politologu Afrim Krasniqi.

DUHEMI ME PAS PAK MËSHIRË PËR THAÇIN

"I ka punët keq. Po e akuzon dikend për bashkëpunim me armikun, Arkanin e Millosheviqin. Nuk po i beson askush. Nuk po i besojnë as në rastin kur po 'zbulon' emrat e bashkëpunësorëve të armikut."

Fjala e tij nuk ka peshë në popullin që e udhëheq zyrtarisht.

Të rralla janë rastet nëpër botë, kur presidentët janë degdisur kaq keq. Dihet se çfarë ka ndodhur me ta pasi e kanë humbur besimin e popullatës. Ai në këto momente është duke ia shtruar vetes, ose Bekim Çollakut, këto pyetje: President i kujt jam unë?

Pse nuk më beson askush?

Mos qoftë kush në lëkurën e tij. Nuk ka situatë më të sikletshme se kjo", ka shkruar gazetari Parim Olluri në profilin e tij në Facebook.

NUK ARRITËM TA KAPËRCEJMË NIVELIN FISNOR

"T'ua lësh në dorë shtetin njerëzve me vetëdije fisnore është njësoj si t'ua lësh në dorë mercedesin barinjve të dhive."

Ne, shqiptarët, nuk arritëm ta kapërcejmë nivelin fisnor, ndaj edhe në këtë gjendje e bijmë shtetin!", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, studiuesi nga Prishtina, Sali Bytyçi.

MEDIA Citate

NË SERBI MENDOHET SE SHBA KA NDRYSHUAR QËNDRIMIN NDAJ KOSOVËS



Aktualisht situata është e tillë që kemi rastin e mirë që çështja e Kosovës të zgjidhet me kompromis, thotë Ivica Dačić. Ai thekson se nuk e dinë do të ketë dhe kur rrethana më të mira. Dačić ka thënë se kanë ndryshuar pozicionet e Rusisë, ajo është bërë superfuqi dhe ka marrëdhënie shumë më të afërta me Serbinë se para 20 vjetësh dhe se ka ndryshuar Amerika e politika e saj e jashtme.

Sipas fjalëve të tij, është hapur mundësia për dialog pasi Serbia ka realizuar marrëdhënie më të afërta me Gjermaninë, Francën e Turqinë ndërsa me Kinën është bërë partnere strategjike. "Në këtë fazë kemi situatën kur Bashkimi Evropian po vëren se problemi kryesor për arritjen e kompromisit janë shqiptarët. Shqiptarët po duan që ne ta njohim Kosovën, plus nëse munden, ta marrin edhe Medvegjen, Preshevën... kjo do të ishte ideale për ta. Në këtë situatë, hapet mundësia që të arrihet zgjidhja e kompromisit. Nëse tashmë ka dialog, në dialog duhet të keni një propozim", raporton TV PINK.

Ai ka theksuar se ardhja e ndihmës sekretarit amerikan të Shtetit Wess Mitchel, ka qenë ngjarja kryesore që e ka ndryshuar qëndrimin e administratës amerikane. "Në këtë kuptim, është me rëndësi se të gjithë përfaqësuesit e administratës amerikane kanë qasje të tillë se problemi i Kosovës nuk është zgjidhur, përkatësisht se duhet bërë përpjekje që me dialog të arrihet marrëveshja që do të ishte në interes për të gjitha palët dhe kështu të mbarojë ky rrëfim", ka thënë Dačić.

(TV Pink, 6 gusht)

NËSE NUK E KENI DITUR...

KUSH ISHIN EVRENOZËT?

Evrenozët ishin familje komandantësh ushtarakë osmanë, veprimtaria e të cilëve lidhet ngushtë me pushtimin e Shqipërisë. Evrenoz Beu luajti rol të rëndësishëm në pushtimin e Ballkanit prej osmanëve gjatë fundit të shek.XIV dhe fillimit të shek.XV. Më 1385 së bashku me bejlerbeun e Rumelisë, Timur Tashin, udhëhoqi forcat osmane në betejën e Savrës kundër Balshës

II, kurse më 1389 mori pjesë në betejën e Kosovës si komandant i pararojës së ushtrisë. Pas vitit 1390 për afro 5-6 vjet drejtoi sulmet e trupave osmane për pushtimin e trevave shqiptare. Vdiq më 1417. Djemtë e tij, Ali, Isa dhe Ahmet, morën pjesë si komandantë ushtarakë në pushtimin e tokave shqiptare gjatë shek.XV.

EDUARD XHOZEF PËR ZGJIDHJEN E KONTESTIT TË EMRIT Marrëveshja e Prespës meriton Çmimin Nobël

Athinë, 6 gusht - Marrëveshja e Prespës meriton Çmimin Nobël, sepse krijoi model të ri për zgjidhjen e kontesteve ndërkombëtare në lidhje me çështjet e identitetit, thotë analisti politik dhe ish-anëtari i Grupit Ndërkombëtar të Krizës, Eduard Xhozef në intervistë për agjencinë greke të lajmeve ANA-MPA. Duke e përsëritur dhe sqaruar qëndrimin e tij në tekstin e tij të publikuar në "Foreign polisi" në qershor të këtij viti shkroi se marrëveshja ndërmjet Maqedonisë dhe Greqisë, por edhe kryeministrat e dy vendeve meritojnë të jenë kandidatë për Çmimin Nobël, Xhozef, i cili është profesor i Universitetit "Xhon Hopkins" në Uashington, thekson se nuk bëhet fjalë për çështje qesharake siç e karakterizuan disa, por se "nevojitet guxim që të bëhet kompromis". "Shkaku i vërtetë për të cilin kjo marrëveshje meriton Çmimin Nobël nuk është vetëm se më në fund zgjidh një problem, por sipas gjitha gjasave krijon model të ri për zgjidhjen e kontesteve ndërkombëtare të cilat janë të lidhura me çështjet e identitetit. Paramendoni në shembullin e kontestit ndërmjet Izraelit dhe Palestinës që ka të bëjë me identitetin e Jerusalemit. Qasja e miratuar në Marrëveshjen e Prespës krijon model ndërkombëtar që meriton tërësisht të merret parasysh për Çmimin Nobël", thotë Xhozef. Siç lajmëron korrespondentja e MIA-s nga Athina, ai në intervistë për ANA-MPA sqaron se karakteristika e qeverive ka luajtur rol të rëndësishëm, sepse në të dyja vendet, në periudhë të njëjtë, kishte liderë me guxim politik që t'i hapin çështjet, dhe jo vetëm të bisedohet, por edhe të hynë në thelb dhe kanë treguar dëshirë për marrëveshje përfundimtare, dhe jo të përkohshme. Në lidhje me reagimet në të dyja vendet, Xhozef thotë se fakti që kritikantët janë të njëjta edhe nga të dyja palët, "qartë tregon se ekziston kompromis i drejtë". "Ai që është i rezervuar duhet ta lexojë vetë marrëveshjen dhe të konfirmojë se janë bërë përpjekje që të mbahet respektimi i rrëfimit historik të secilit vend. Dhe tani kemi një çështje, e cila në të vërtetë, mbeti e hapur për rreth 100 vite, sepse rrënja është që nga koha e Luftërave Ballkanike, të mbyllet njëherë e përgjithmonë", sqaron profesori në intervistë, transmeton MIA. Ai shton se marrëveshja i shërben interesit strategjik të Greqisë dhe ndihmon që vendi të marrë rolin e fuqisë rajonale.

NË PRITJE TË EUFORISË "PRO" APO "KUNDËR" REFERENDUMIT

ÇELËSI TE PËRKRAHJA NDËRKOMBËTARE

VMRO ende nuk ka qëndrim zyrtar për bojkot të Referendumit, por kundërshton ashpër Marrëveshjen për emrin me Greqinë. Të lidhur direkt apo indirekt me VMRO-në, një sërë organizatash dhe parti të vogla politike, prej tyre njëra me orientim prorus, mbajnë qëndrime radikale kundër Referendumit. Me interes po priten jo vetëm qëndrimet zyrtare të bashkësisë ndërkombëtare, por edhe veprimet e saj diplomatike përfshirë dhe kanalet interne, që të ndihmojnë pushtetin për kalimin me sukses të 30 shtatorit

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 6 gusht - Pushteti dhe opozita vazhdojnë të jenë të ndara sa i përket organizimit të Referendumit. Në LSDM konsiderojnë se Marrëveshja me Greqinë, për të cilën dhe do të organizohet Referendumi më 30 shtator, është akt patriotik me të cilën mbyllet kontesti 25 vjeçar dhe sigurohet një ardhmëri më e mirë për Maqedoninë. Nga ana tjetër, VMRO ende nuk ka qëndrim zyrtar për bojkot të Referendumit, por e kundërshton ashpër Marrëveshjen. Të lidhur direkt apo indirekt me VMRO-në, një sërë organizatash dhe parti të vogla politike, prej tyre njëra me orientim prorus, mbajnë qëndrime radikale kundër Referendumit. Me interes po priten jo vetëm qëndrimet zyrtare të bashkësisë ndërkombëtare, por edhe veprimet e saj diplomatike përfshirë dhe ata interne, që të ndihmojnë pushtetin për kalimin me sukses të Referendumit. Veçanërisht qasja ndërkombëtare pritet të jetë më direkte dhe këmbëngulëse ndaj partisë më të madhe opozitare - VMRO. Sipas asaj që flitet kuluareve politike, diplomacia perëndimore pritet të rezultojë me sukses për të bind VMRO-në që të mos e pengojë realisht mbajtjen e Referendumit. Në të kundërtën, një bojkot i VMRO-së më të gjitha mekanizmat e saj politik që ka në terren mund të rezultojë fatale ditën e votimit.

Në taborin shqiptar situata është më pozitive s ai përket qëndrimit dhe veprimit pozitiv pro Referendumit. E vetmja parti që mban zërin kritik, edhe pse formalisht pro Referendumit, është Aleanca për Shqiptarët e Ziadin Selës. Indikacione negative tjetër është se shumë shqiptarë vitet fundit kanë dalë jashtë vendit, dhe pak janë mundësitë që të votohet në përfaqësitë diplomatike të Maqedonisë. Shpresat në këtë drejtim janë tek partia shqiptare në pushtet - BDI, që ka terren



KURCI VJEN TRE JAVË PARA REFERENDUMIT

Në përkrahje të Referendumit, me rëndësi të madhe politike do të jetë edhe vizita në Maqedoni më 7 shtator e kancelarit të Austrisë, Sebastian Kurc, që aktualisht kryeson me Bashkimin Evropian. Kjo, për faktin se Kurc njihet për zyrtarë evropian i afërt me VMRO-në, ndërsa shihet edhe si çelësi kryesor që mund të bind partinë e Hristijan Mickovskit që të mos e pengojë referendumin. Vizita e Kurcit në Maqedoni vjen pas ftesës që kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, ia



ka bërë të njëjtit dhe shumë kryeministrave tjerë të Evropës, që të gjitha priten të realizohen para Referendumit që mbahet më 30 shtator ku qytetarët e Maqedonisë do të përgjigjen në pyetjen: "A janë për anëtarësim në NATO dhe BE me pranimin e marrëveshjes me Greqinë?". Në takimin e fundit Kurc-Zaev që u realizua në Vjenë, në fund të qershorit, Kurc apeloj deri te qytetarët e Maqedonisë që në Referendum të votojnë "për" emrin "Republika e Maqedonisë së Veriut".

në diasporë e që mund të bëjë që shumë mërgimtarë të votojnë në Maqedoni. Në opinionin shqiptarë gjithashtu ka zëra kundër përkrahjes pa kushte ndaj palës maqedonase për Referendumit. Megjithatë, pas mesit të gushtit - partitë në pushtet pritet të jenë më euforike në fushatë për votimin e 30 shtatorit. Të qenurit në pushtet atyre u jep përparësinë që të punojnë më shumë me qytetarët për të votuar pro në Referendum. Në komunikatën e fundit për shtyp, LSDM thotë se Marrëveshja për emrin jo vetëm forcon identitetin e kombit maqedonas, por edhe largon pengesën e fundit për procesin euroatlantik.

"Pas viteve të izolimit, Maqedonia përsëri është në rrugën drejt BE-së dhe NATO-s. Data për fillimin e bisedimeve me BE-në është definuar, ndërsa është siguruar edhe ftesë për hyrje në NATO. Në Referendumin e 30 shtatorit, qytetarët e kanë fjalën e fundit për ardhmërinë e Maqedonisë në BE dhe në

NATO. Qytetarët janë bartës të sovranitetit, ata zgjedhin në zgjedhje dhe në Referendum, ndërsa vullneti i tyre është i pakthyeshëm dhe i detyrueshëm për të gjithë", thuhet në kumtesë. Qytetarët, thonë më tej në LSDM, e njohin rëndësinë historike të Referendumit, e dinë se Marrëveshja për çështjen e emrit me Greqinë është historikisht më e mira dhe mundësia e drejtë që njëherë e përgjithmonë të sigurohet ardhmëria e Maqedonisë, njëherë e për gjithmonë të sigurohet dhe të garantohet identiteti maqedonas.

"Shumica e qytetarëve fuqishëm janë të përcaktuar për hyrje në BE dhe NATO dhe për atë më 30 shtator, në Referendum të lirë, pa presion, me vendosmëri dhe me dinjitet do të thonë PO për BE dhe NATO përmes pranimit të Marrëveshjes me Greqinë, fuqishëm dhe me vendosmëri do të thonë PO për ardhmërinë e Maqedonisë", thuhet në kumtesën e LSDM-së.

NË DUKJE ELEMENTI RADIKAL

Ngjashëm me VMRO mendojnë edhe afër 30 organizata joqeveritare që janë bashkuar në një front për të nisur fushatën për bojkotin e Referendumit. Një nga drejtuesit e këtij fronti, Janko Baçev nga partia "Maqedonia e Bashkuar", e që vepron sipas kursit të partisë "Rusia e Bashkuar" të presidentit rus, Vladimir Putin, ka thënë se pas dështimit të Referendumit, do të përgjigjen të gjithë ata që, sipas tij, kanë

tradhtuar interesat kombëtare. "Qeveria e re dhe legjitime që do të vijë pas 30 shtatorit do të qërojë hesapet me të gjithë tradhtarët e kombit. Të gjithë ne do të bojkotojmë Referendumin më 30 shtator. Nuk do të dalim në Referendum dhe me këtë ne do ta shpëtojmë emrin shekullor maqedonas", ka deklaruar Baçev, i cili në protestat e muajit të kaluar kundër Marrëveshjes me Greqinë, ishte parë duke valëvitur në duar flamurin e Rusisë.

"Kornizë e fuqishme ligjore dhe institucione të sigurta janë të nevojshëm për vënien e një politike koherente për prevenim dhe pengim të korrupsionit. Shtetet anëtare patjetër të sigurojnë respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe të drejtat qytetare", thuhet në Kapitullin 23 të Komisionit Evropian

Koha

Evis HALILI

Shkup, 6 gusht - Gjendja në gjyqësor, reformat në këtë sferë, ligjet, sa në vend ka sundim të së drejtës, gjykata transparente dhe efikase, gjykatës të paanshëm dhe prokurorë publik, departizim dhe organe gjyqësore në shërbim të qytetarëve që duhet të gëzojnë të drejtat e tyre njerëzore do të jenë në fokusin e procesit të skringut për përgatitje të vendit për negociata inkuadruese me BE-në. Kapitulli 23 që i referohet gjyqësorit dhe të drejtave themelore do jetë e para që do të vihet në thjerrën e BE-së, ndërsa siç është paralajmëruar ajo do të ndodhë në shtator.

Kalendari i procesit të skringut është vërtetuar, ndërsa për këtë paralajmëroi në fundin e muajit të kaluar edhe zëvendëskryeministri për çështje evropiane, Bujar Osmani, i cili është caktuar për negociator politik. Është dakorduar edhe kalendari përfundimtar për skanimin e kapitujve, ndërsa Qeveria veçmë ka miratuar edhe strukturën negociuese për inkuadrimin e RM-së në BE.

"Kemi kalendarin e plotë se si do të ndodhë e gjithë kjo deri në korrik 2019. Megjithatë, paralelisht punojmë në vënien e strukturës dhe përgatitjes së shtetit për këtë proces të rëndësishëm", ka thënë Osmani gjatë fundit të muajit të kaluar. Pas kapitujve 23, fillon skringu i kapitujve 24, ndërsa pasojnë 5.30... Politikën e BE-së në sferën e gjyqësorit dhe të drejtave fundamentale kanë për qëllim të mbajnë edhe më tej të zhvilluar Unionin si hapësirë për liri, siguri dhe drejtësi. KE në faqen e saj ku sqaron kapitujt, në pjesën e kapitullit 23 thekson se ven-

KONFIRMOHET KALENDARI I SKRINGUT

GJYQËSIA, E PARA NËN THJERRËZËN E BE-SË



dosja e gjyqësisë së pavarur dhe efektive është me rëndësi esenciale për çdo vend që dëshiron të bëhet pjesë e BE-së. Paanshmëria, integriteti dhe standardet e larta të punonjësve gjyqësor janë esenciale për sundimin e vërtetë të së drejtës.

E gjithë kjo, thekson KE, kërkon synim të fortë se do të eliminohen ndikimet e jashtme mbi gjyqësinë dhe do të sigurohen burime adekuate dhe stërvitje për punonjësit në këtë sektor.

Unioni kërkon garanci ligjore për organizimin e proceseve gjyqësore dhe fer. Shtetet anëtare patjetër që në mënyrë të barabartë të angazhohen kundër korrupsionit, pasi ajo paraqet kërcënim për stabilitetin e institucioneve demokratike dhe sundimit të së drejtës. "Kornizë e fuqishme ligjore dhe institucione të sigurta janë të nevojshëm për vënien e një politike koherente për pre-

venim dhe pengim të korrupsionit. Shtetet anëtare patjetër të sigurojnë respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe të drejtat qytetare", thekson Komisioni. Qeveria intensivisht përgatitet për skringun, ndërsa paralelisht zhvillohen edhe proceset e implementimit të marrëveshjes së Prespës dhe organizimi i referendumit vijues. Kryeministri Zoran Zaev beson në gjyqësinë e Maqedonisë shumë më shumë se në të kaluarën, por jo tërësisht. Në intervistën që të premten e dha për 1TV theksoi se vendi duhet të arrijë në nivel kur ligjet njëjtë do të vlejnjë për të gjithë dhe theksoi se reformat në këtë sferë janë në filllet e saj.

Skringu zyrtarisht ishte hapur në 17 të muajit të kaluar me vizitën e eurokomisarit për zgjerim Johannes Han në Shkup. Ai në fakt është proces i kontrollit analitik të legjislacionit evropian që aplikohet në kuadër

të procesit të bisedimeve inkuadruese. Çdo shtet që është bërë anëtare e BE-së ka kaluar nëpër këto procese. Në gjitha fazat ajo mund të zgjas prej një deri dy vjet dhe i njëjti është i unifikuar për të gjitha vendet, pasi legjislacioni evropian vlen për të gjithë njësoj. Sipas përvojave para-prake të shteteve që kanë kaluar këtë proces para nesh apo ata që për momentin negociojnë, më të ndjeshme janë kapitujt 23 (Gjyqësia dhe të drejtat fundamentale) dhe 24 (Drejtësi, liri dhe siguri). Në pajtueshmëri me praktikën e re të KE-së në negociatat të parat hapen mu këto dy kapituj.

Gjithsej ka 35 kapituj, por vetëm në 33 ka legjislacion konkret evropian (Acquis). Kapitulli 34 është për vërtetimin e çështjeve institucionale, derisa ai 35 është për gjithçka nga pjesa e "ngelur".

PADI PËR GJUHË TË URREJTJES NË MEÇKIN KAMEN

Prokuroria Publike e Prilepit po vepron për kallëzimin penal të mbërritur kundër dy personave dhe personave të tjerë të panjohur për vepër të kryer penale "Shkaktim i urrejtjes, përçarjes apo jotolerancës në bazë kombëtare, racore, fetare dhe ndonjë bazë tjetër diskriminuese" gjatë shënimit të festës së Ilindenit në Meçkin Kamen. "PTH P Prilep po ndërmerr aksione për konfirmim të fakteve dhe grumbullimit të dëshmive lidhur me sulmet dhe gjuhën e urrejtjes të cilat janë shqiptuar gjatë shënimit të festës shtetërore në Meçkin Kamen", thuhet në kumtesën nga Prokuroria Publike. Në Prokurori, siç thuhet, ka mbërritur kallëzim penal i dorëzuar nga MPB - SPB Manastir, kundër dy

personave dhe personave të tjerë të panjohur për vepër të kryer penale - Shkaktim i urrejtjes, përçarje ose jotolerancë në bazë kombëtare, racore, fetare dhe bazë tjetër diskriminuese nga neni 319 nga Kodi Penal. "Me kallëzimin penal të dy të dyshuarve, banorë të Manastirit, së bashku me tani për tani ende persona të panjohur, ngarkohen se gjatë kremtimit kanë përdorur gjuhë të urrejtjes e cila është vërejtur në video xhirimin e emetuar në njërin nga televizionet kombëtare. Prokurori kompetent nga Prokuroria Themelore Publike Prilep në vazhdimësi ndërmerr aksione që ta pastrojë ngjarjen penalo-juridike", thuhet në kumtesë.

Gjobat doganore zvogëlohen për 75 për qind

Shkup, 6 gusht - Mesatarisht për 75 për qind zvogëlohen gjobat për kundërvajtjet doganore për të cilat është parashikuar urdhër pagesë e detyrueshme, apo për ato të cilat mund të paguhen në vendin përkatës. Me ndryshimet e Ligjit të doganës, kumtojnë nga Ministria e Financave, bëhet zvogëlimi i gjobave prej 250 në 50 euro për person juridik dhe nga 50 euro në 15 për person fizik. Siç theksoi mi-

nistri i Financave, Dragan Tevdovski, qëllimi i ndryshimeve është përmirësimi i legjislacionit në drejtim të krijimit të aplikimit të drejtë dhe proporcional të dispozitave kundërvajtëse, konform rëndësisë së veprës së kryer. Me ndryshimet e Ligjit të doganës mundësohet edhe qarkullim më i shpejtë i mallrave. Në të fakt, ai mundëson njohjen reciproke të lejeve të dhëna për operator të au-

torizuar ekonomik në suaza të CEFTA-s.

Ky është përfitim i madh për Shokat tregtare të Maqedonisë të cilat tregtojnë në rajon. Njohja e lejeve për operatorin ekonomik do të mundësojë qarkullim më të shpejtë të mallit të eksportuar, më pak kontrolle fizike dhe të dokumentuara dhe mundësi të zgjidhet vendi ku do të realizohen kontrollet. E gjithë kjo do të kon-

tribujë në lehtësimin e tregtisë rajonale. Me ndryshimet e ligjit bëhet edhe harmonizimi me Konventën për procedurë të përbashkët transitore. Me to do të harmonizohen dispozitat të cilat kanë të bëjnë me garantimin në sigurimin e pagesave të borxhit doganor ose taksa tjera lidhur me mallrat në procedurë transitore. Ndryshimet e ligjit hyjnë në fuqi kah mesi i këtij muaji.

Përgjysmohet numri i haxhilerëve, këtë vit vetëm 672!

Shkup, 6 gusht - Nga Maqedonia, këtë vit në Haxh do të shkojnë 672 besimtarë të cilët prej 11 deri më 15 gusht do të udhëtojnë me katër aeroplanë me fluturim çarter. Këtë e deklaroi sekretari i përgjithshëm i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë, Irsal Jakupi. Shkaku i përgjysmimit të numrit të besimtarëve që do të kryejnë kushtin e pestë të Islamit, është rritja e çmimit të Haxhit të caktuar nga BFIM-së, që këtë vit shënon rritje për 700 euro më shumë se sa vitin e kaluar. Vitin e kaluar në Haxh kishin shkuar rreth 1300 besimtarë, ndërsa çmimi ishte 4000 dollarë apo 3400 euro. Këtë vit, çmimi i Haxhit ka shkuar në 4100 euro, apo 700 më shumë se sa në 2017. Asnjë arsytim për rritjen e çmimit nuk ka dhënë deri më sot BFIM, ndërsa hesht edhe te akuzat lidhur me shitjen e vizave, apo futjen e tyre në çmimit të përgjithshëm, edhe pse të njëjtat jepen falas nga autoritetet e Haxhit të Arabisë Saudite. Ulje të numrit të haxhilerëve është shënuar në të gjitha qytetet me shumicë shqiptare në vend, ndërsa akuza ndaj BFIM ka edhe për çmimin e vaksinave, pasi të njëjtat jepen falas nga Republika e Turqisë. Ndryshe nga BFI tjera në Rajon, konkretisht nga ajo e Kosovës dhe Shqipërisë, BFI e Maqedonisë këtë vit ka shënuar rritjen më të madhe të çmimit të Haxhit, ndërsa ka ulur edhe numrin e ditëve të qëndrimit të haxhilerëve në Meke dhe Medine. Akuzat kundër BFIM dhe kreut të saj, Sulejman Rexhepi, se po malverzon me Haxhin janë aktualizuar së fundmi nga deputeti i LSDM-së, Muhamed Zeqiri, i cili nga foltorja e Parlamentit, i bëri thirrje autoriteteve shtetërore për mbikëqyrjen e, siç tha ai, malverzimeve që Resisi i BFIM-së i kryen në institucionin fetar. Madje, ai ka dorëzuar kërkesë për ngritjen e hetimeve kundër Rexhepit edhe në Prokurorinë Speciale të Katica Janevës.

(R.K)

PARALELE ME TRE NXËNËS NË SHKOLLAT PROFESIONALE



Drejtorët e shkollave akuzojnë se politika e gabuar e MASH-it gjatë viteve të kaluara është fajtori kryesor që nxënësit nuk duan të mësojnë nëpër shkollat me zanate të ndryshme

DO TË MBESIM PA SALDATOR, MJESHTËR UJI, BRAVA NDREQËS...

Koha

Aida XHONI

Shkup, 6 gusht - Në Maqedoni mungojnë punëtorë nga më shumë sektorë të makinerisë, hotelierisë, elektroteknikës, bujqësisë... Për disa vite, vështirë do të gjendet saldator, montues apo brava-ndreqës, pasi askush nuk regjistrohet në programet trevjeçare nëpër shkollat e mesme, të cilat kanë drejtime për këto kuadro, edhe pse janë kuadro deficitare në shtet. Drejtorët e shkollave të mesme profesionale në mënyrë dëshpëruese kërkojnë mënyrë ti joshin të rinjtë që të mësojnë në këto veprimtari. Ata shpresë shohin vetëm në arsimin dual.

Më këtë problem tanimë ballafaqohet Manastiri. Në shkollën e mesme teknike komunale "Gjorgji Naumov", në Manastir, këtë vit nuk është paraqitur asnjë gjysmëmaturant që të mësojë në shkollën e mesme trevjeçare në drejtimin makineri-përpunues për metal-saldator dhe instalues të ngrohjeve dhe kondicionerëve-teknik i makinerisë energjetike. Për elektromekanik, gjithashtu program trevjeçar, janë paraqitur vetëm shtatë nxënës, dhe nuk dihet nëse do të kenë sukses që të formojnë paralele.

"Për drejtimin trevjeçar makineri, nuk kemi asnjë nxënës këtë vit, ndërsa ky kuadër është mjaftë i kërkuar në tregun e punës. Dy kompani nga Manastiri kërkojnë nga 20-30 nxënës të punojnë si saldues, disa si brava-ndreqës, ndërsa ne nuk e kemi asnjë që t'ua propozojmë. Nga njohuritë e mija, paga fillestare në këtë lëmi është 17.000 denarë", thotë Vlladimir Rome, drejtor i shkollës. Ai vlerëson e problem i madh është edhe fakti se sipas konkursit të ri për regjistrim nëpër shkollat të mesme, është ndërprerë afati regjistruar i gushtit.

Nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës thonë se regjistrimi i nxënësve nëpër shkollat të mesme realizohet në vazhdimësi. "Nga 20.699 nxënës, të cilët këtë vit e kanë përfunduar klasën e nëntë, në dy afatet regjistruar të qershorit janë regjistruar 15.310 nxënës. Duke pasur parasysh faktin se ne

shumë shkolla ka ende vende të lira, jemi të bindur se asnjë nxënës i cili i plotëson kushtet, nuk do të mbetet jashtë procesit edukativo-arsimor", thonë nga MASH-i. Drejtorët e shkollave akuzojnë se politika e gabuar e MASH-it gjatë viteve të kaluara është fajtori kryesor që nxënësit nuk duan të mësojnë nëpër shkollat me zanate të ndryshme. "U popullarizuan gjimnazet, por ja edhe aty nuk ka fëmijë. Problem është që të gjithë shikojnë të mësojnë arsim të mesëm katër vjeçar që të mund të shkojnë në fakultet. Askush nuk dëshiron të mësojë tre vjet. Gjithashtu, vlerësoj se MASH-i nuk duhet të përzihet në politikën regjistruar të shkollave. Duhet të lejohet që këtë ta bëjë vetëqeverisja lokale, e cila më së miri di se çfarë kuadri i duhet secilit qytet, sepse kanë bashkëpunim të ngushtë me bizneset dhe ekonominë", thonë drejtorët e shkollave. Edhe në shkollën e mesme "8 Shtatori", të Qytetit të Shkupit, këtë vit ka rekord numër të vogël të nxënësve të paraqitur për programet tre vjeçare. Drejtoresha Elizaveta Mladenovska thotë se për dy profilet arsimore - instalues i ujit dhe saldator-përpunues të metalit, janë paraqitur vetëm tre nxënës dhe për arsim në gjuhën maqedonase dhe shqipe.

"Parashtruar lutje në Qytetin e Shkupit që të na lejojë të formojmë paralele. Njëjtë sikur edhe çdo vit ballafaqohemi me numër të ulët të nxënësve, këtë vit qëndrojmë më së keqi me numrat. Mendohe-

mi të tërheqim më shumë nxënës, përgatim video promovuese, marrim pjesë nëpër emisione, por thjeshtë nxënësit nuk dëshirojnë të mësojnë. Nuk e kam të qartë përse gjimnazet janë aq tërheqës", thotë Mlladenovska. Edhe për drejtimet tjera katërvjeçare në këtë shkollë mezi se janë regjistruar nga dhjetë kandidatë. Mlladenovska gjithashtu vlerëson se nevojitet afirmim më i madh i këtyre profileve. Ajo si model të mirë e potencon arsimin dual të cilin veç më e ka shkollë "Mihajlo Pupin".

Me numër ekstrem të zvogëluar nxënësish ballafaqohen edhe një pjesë e shkollave të mesme bujqësore. Shkollat e mesme komunale të bujqësisë nuk kanë më shumë se 45 nxënës. Dhe kjo po ndodhë pothuajse në secilin qytet. "Kemi pesë profile arsimore. Vjet regjistruam 7, ndërsa sivjet 13 nxënës. Në shkollë ka vetëm 45 nxënës. Ndërtesa është e madhe dhe mund ta paramendonim se si duket. Për fat të mirë këtu i kemi edhe nxënësit e gjimnazit të sportit dhe duket një farë gjallërie", thotë Bllagojçe Krivevski, drejtor i shkollës së bujqësisë në Manastir.

Situatë e njëjtë është edhe në Kumanovë, Tetovë, Gostivar e Strugë. Paralele të shumta janë shuar, pasi interesimi i nxënësve është mjaft i vogël. Fokusi vazhdon të jetë te gjimnazet dhe mjekësia, ndërsa MASH deri tani nuk ka ofruar asnjë strategji për zbutjen e situatës në shkollat trevjeçare profesionale.

HETOHET EDUKATORJA QË FYENTE FËMIJËT NË KOPSHTË

Pas publikimit të një videoje në rrjetet sociale nga kopshti "Detska radost" në Gjevgjeli kur edukatorja me fjalë fyese i drejtohet një fëmije, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale urgjentisht ka reaguar me qëllim të ndriçimit të rastit në një afat më të shpejtë të mundshëm. "Repartit për mbikëqyrje inspektuese për mbrojtjen e fëmijëve menjëherë ka kontaktuar me drejtorin e institucionit, ndërsa inspektorët kanë shkuar në terren që të kryejnë mbikëqyrje të

jashtëzakonshme inspektuese. Nëse konfirmohet besueshmëria e ngjarjes, të gjithë përgjegjësit menjëherë do të sanksionohen. MPPS nuk do të tolerojë çfarëdo qoftë sjellje jopërkatese me fëmijët në kopshte", thuhet në kumtesën e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale. Nga MPPS informojnë se në afat sa më të shkurtër do ta njoftojnë opinionin për rrjedhën dhe hapat lidhur me këtë rast.

Lajme shkurt

Digjet një makinë në Çento

Shkup, 6 gusht - Një makinë mëngjesin e djeshëm është përfshirë nga flakët në rrugën "Metodija Andonov Çento" nr. 161 në Shkup. Siç ka informuar komandanti i Brigadës për mbrojtje kundër zjarreve në Qytetin e Shkupit Zvonko Tomeski, rasti është paraqitur në "193" mëngjesin e sotëm në ora 3:05, ndërsa zjarri është shuar në ora 4. "Janë djegur pjesë të makinës dhe është shkaktuar dëm material prej rreth 60 mijë denarë. Është intervenuar me një automjet dhe katër zjarrfikës", ka deklaruar Tomeski. Brigada kundër zjarreve në Qytetin e Shkupit mëngjesin e sotëm në ora 2:40 ka intervenuar edhe në një banesë në bulevardin "Arradhat partizane" në Shkup. Për shkak të instalacionit të djegur elektrik flakët kanë përfshirë dy metra katrorë dhe është shkaktuar dëm material prej nëntë mijë denarësh. Rasti është paraqitur në "193", ndërsa na shuarjen e zjarrit kanë intervenuar tre zjarrfikës me një automjet.

Deri në fund të javës mot i ngrohtë deri në 37 gradë

Shkup, 6 gusht - Mot me diell dhe i ngrohtë me temperatura edhe deri në 37 gradë dhe UV indeks të lartë, paralajmërojnë sinoptikët deri në fund të javës. Ditëve të ardhshme, sipas DPHM-së, është e mundur të ketë edhe vranësira të vogla deri në mesatare lokale. Të enjten do të ketë kushte për reshje afatshkurta lokale të shiut dhe paraqitje të bubullimave.

Rregullohen 12 mijë m² gjelbërim në Shkup

Shkup, 6 gusht - Ekipet e Qytetit të Shkupit dhe të Ndërmarrjes Publike "Parqe dhe Gjelbërime" kanë rregulluar katër sipërfaqe të gjelbra në kryeqytet. Në bulevardin "Shën Klimenti i Ohrit" para ndërtesës me numër 54 është rregulluar shesh i gjelbër me sipërfaqe prej 800 metra katrorë. Është vendosur rrjet hidratues prej 150 metrave, katër puse, tre hidrante dhe 12 spërkatëse. Shesh i gjelbër është rregulluar edhe në rrugën "Lazar Liçenovski" nën Kala, në sipërfaqe prej 819 metra katrorë. Është vendosur rrjet hidratues prej 20 metrave, shtatë puse, katër hidrante dhe 17 spërkatëse. Është rregulluar edhe gjelbërimi prej 5.684 metrave katrorë midis rrugëve "brigada e Dytë e Maqedonisë" dhe "Lazo Tërpkovski". Në këtë sipërfaqe të gjelbër është vendosur rrjet hidratues prej 450 metrave, 11 puseve, tetë hidratuesve dhe 74 spërkatëseve. Sipërfaqe e gjelbër publike është rregulluar edhe në bulevardin "Kërste Misirkov" deri në Qendrën kulturore rinore.

Në Qytetin e Shkupit kanë treguar mirëkuptim për këta tregtarë që punojnë nëpër këto tezga të vendosur ilegalisht, dhe për këtë shkak, në bashkëpunim me "Skopski Pazar", u kanë siguruar dhe ofruar tezga për shfrytëzim në kuadër të Bit Pazarit, me kushte shumë të volitshme. Ata dy muajt e parë kanë mundur ti shfrytëzojnë pa pagesë, ndërsa më pas ti paguajnë njëjtë si edhe shitësit tjerë

INSTITUCIONET TOLEROJNË SHITËSIT ILEGAL QË PO BLOKOJNË TROTUARET

LIROHET ANA E BIT PAZARIT, BLOKOHET AMBULANCA



Shkup, 6 korrik - Shitësit ilegal të Bit Pazarit kanë zaptuar territor të ri dhe tani çdo të marte dhe të premte - organizojnë treg të tërë para ambulancës së Bit Pazarit. Në tokë, kutia kartoni... shiten ushqime të ndryshme, si pemë dhe perime. Pulat dhe zogjtë gjithashtu ofrohen për shitje, pikërisht para hyrjes kryesore të ambulancës. Pak më anej, drejt stacioneve të autobusëve, në kuti kartoni shiten tekstil dhe enë të ndryshme, e si pasojë - trotuaret janë të uzurpuara tërësisht. Diku-diku realizohen punë ndërtimore, me gjasë për ndërtim të korsive për biçikleta, ndërsa këmbësorët me të vërtetë janë në kërkim të hapësirës së lirë. Kurdo që të kalojnë anej, vazhdimisht dëgjoen komente të llojit se kreu i Shkupit, Petre Shilegov,

ka përzënë shitësit e egër nga njëra anë, ndërsa ata janë vendosur në anën tjetër të Bit Pazarit.

Nga Agjencia për Ushqim dhe Veterinari thonë se për produktet e tilla, madje edhe nëpër tregjet e gjelbra të organizuara, ata ligjërisht nuk janë kompetent dhe shtojnë se kjo është detyrë e inspektorëve komunal. Nga Qyteti thonë se dy anët e Bulevardit "Kërste Petkov Misirkov", në Bit Pazar, do të jenë të lira për lëvizjen e këmbësorëve dhe biçikletave.

"Këto ditë ekipet inspektuese realizuan edhe një aksion për çlirim të hapësirës publike në afërsi të Bit Pazarit. Qyteti i Shkupit nuk do



të tolerojë uzurpimin e hapësirës publike nga grupe dhe individ, hapësirë kjo e cila është e dedikuar për qarkullim të lirë të qytetarëve dhe do të vazhdojmë të ndalojmë

këtë dukuri. Këtë vit janë realizuar një numër i madh aksionesh të koordinuara për largimin e tezga-ve të egra para tregjeve të mëdha të gjelbra, ndërsa janë larguar

edhe automjetet e shitësve jo-legal nga më shumë lokacione. Si institucione ne kemi obligim ligjor ti lirojmë rrugët dhe trotuaret nga çdo gjë që e pengon realizimin normal të komunikacionit, ku marrin pjesë automjetet motorike, biçikletat dhe këmbësorët", thonë nga Qyteti i Shkupit. Ata thonë se kanë treguar mirëkuptim për këta tregtarë që punojnë nëpër këto tezga të vendosur ilegalisht, dhe për këtë shkak, në bashkëpunim me "Skopski Pazar", u kanë siguruar dhe ofruar tezga për shfrytëzim në kuadër të Bit Pazarit, me kushte shumë të volitshme. Ata dy muajt e parë kanë mundur ti shfrytëzojnë pa pagesë, ndërsa më pas ti paguajnë njëjtë si edhe shitësit tjerë.

Autoritetet e Qytetit të Shkupit shtojnë se në bashkëpunim me të gjitha institucionet tjera kompetente, do të vazhdojnë të veprojnë në drejtim të zhdukjes së kësaj dukurie, në pajtueshmëri me ingerencat e tyre ligjore, për përmirësimin e jetës së banorëve të Shkupit. Megjithatë, të vetmen gjë që e bëri Qyteti i Shkupit është vetëm dislokimi nga ana e Pazarit të shitësve ilegal, ndërsa askush nuk i prek në anën tjetër - aty para Ambulancës. (A.XH)

ODA EKONOMIKE E KËNAQUR ME PËRKRAHJEN FINANCIARE NGA QEVERIA

TË NDRYSHOHET MODELI PËR RRRITJEN EKONOMIKE

Shkup, 6 gusht - Oda e Ekonomike e Maqedonisë (OEM) është e kënaqur me mënyrën se si po zbatohet Ligji për përkrahje financiare, megjithatë kërkojnë nga Qeveria të ndryshojë modelin e deritanishëm për rritje ekonomike. Ljupka Trajkovska nga OEM thotë se papunësia e madhe si dhe dinamika e dobët e rritjes reale ekonomike janë fakte të pamohueshme se duhet të ndryshohet modeli deri tanishëm për rritje ekonomike, e cila duhet të çojë në ndryshimin e strukturës ekonomike të afaristëve, si dhe politikën makroekonomike. "Në këtë kontekst, Oda Ekonomike e Maqedonisë iniciacion bisedime me bartësit e politikave ekonomike për realizimin e propozimeve apo masave konkrete për zbatimin adekuat të tyre që do sillin deri te ndryshimi i modelit zhvillimor të deritanishëm. Ky model i ri për rritje ekonomike



kërkon bashkëpunim më të lartë me të gjithë faktorët relevant në vend, më qëllim të arritjes të një konsensusi në atë mënyrë që të mobilizohen të gjithë bartësit e ndryshimeve të patjetërsueshme e që për periudhë afatmesme, ekonomia e Maqedonisë të shënojë rritje të shpejtë ekonomike", tha Trajkovska. Edhe përkundër inicimit të ndryshimit të modelit

të deritanishëm të rritjes ekonomike, Trajkovska në vazhdim shprehet se OEM është e kënaqur se 182 kompani kanë aplikuar për marrjen e ndihmave shtetërore, mirëpo numri i kompanive që kanë mbyllur vitin afaristë me sukses, është më i madh se sa numri i kompanive që kanë aplikuar dhe kanë fituar të drejtën e marrjes së ndihmave shtetërore. "Nuk është

për t'u nënçmuar numri prej 182 kompanive, por është larg asaj së mjaftueshmes. Ka kompani të cilat përveç që kanë investuar me financa të tyre tre vitet e fundit, njëherazi kanë rritur numrin e punëtorëve dhe kanë qenë të suksesshëm, por nuk kanë aplikuar për marrjen e ndihmave shtetërore", tha Trajkovska. Prandaj ajo paralajmëroi se OEM do të fillojë me promovimin e nevojës për investime plotësuese nga ana e shtetit për sektorin e biznesit privat dhe përmes takimeve të drejtpërdrejta me ta t'i inkurajojnë kompanitë e suksesshme të aplikojnë dhe të shfrytëzojnë ndihmat shtetërore që Qeveria i ndan secilin vit. "Vetëm përmes ndihmave shtetërore, firmat e mëdha dhe të suksesshme mund ta rrisin konkurrencën si kompani eksportuese të orientuara në prodhimtari që dukshëm do të kontribuojnë në lë-

vizjen e ekonomisë. Kjo, njëherësh është edhe qëllimi i OEM-së dhe në vitin 2011, propozuan disa masa që kanë për qëllim ndryshimin e modelit të tanishëm për rritje ekonomike", tha Trajkovska. Të dhënat e fundit të OEM-së, informoi ajo, tregojnë se gjatë periudhës së kaluar është kryer deindustrializimi i ekonomisë që dukshëm ka ndikuar në mos zhvillimin e mirë ekonomik të vendit. "Nga viti 1992 e deri në vitin 2016, dyfishitë është zvogëluar pjesëmarrja e sektorit industrial në krijimin e Bruto Prodhimit Vendor dhe nga 32 është ulur në 15 për qind. Ndërsa për periudhën 10 vjeçare, nga viti 2006 e deri në vitin 2016 pothuajse është përgjysmuar numri i kompanive konkurruese të orientuara për eksportin e prodhimeve dhe atë nga 675 është ulur në 461 kompani", tha Trajkovska. (Z.V)

LAJME SHKURT

Për gjysmë denari
shtrenjtohet

Eurosuper BS-95

Shkup, 6 gusht - Benzina Eurosuper BS-95 nga mesnata shtrenjtohet për gjysmë denar, ndërsa çmimi me pakicë i Eurosuper BS-98, i Eurodiselit dhe Vajit ekstra të lehtë për amvisëri mbetet i pandryshuar. Sipas vendimit të Komisionit Rregullator për Energjetikë, çmimi i ri i Eurosuper BS-95 do të jetë 71,50 denarë për litër. Çmimi i Eurosuper BS-98 mbetet 73 denarë, i Eurodiselit 62,50, ndërsa i Vajit ekstra të lehtë për amvisëri 51,50 denarë. Në pajtueshmëri me vendimin, ulet çmimi i mazutit dhe do të jetë 33,65 denarë për kilogram. Çmimi mesatar i naftës së papërpunuar në tregun botëror është 73,86 dollarë për barel, ndërsa kursi i denarit në krahasim me dollarin ishte 52,43 denarë për një dollar.

Turistët në tremujorin
e parë kanë shpenzuar
64.7 milionë dollarë

Shkup, 6 gusht - Gjashtëdhjetë e katër milionë dollarë amerikan kanë shpenzuar në tre muajt e parë të vitit, turistët në udhëtimet nëpër Maqedoni. Të hyrat devizore në këtë tremujor, siç ka informuar Agjencia për promovim dhe mbështetje të turizmit, prej 64.71 milionë dollarë amerikan shënon rritje prej 26.5 për qind në krahasim me periudhën prej vitit të kaluar. Sipas Agjencisë, rritja në vazhdimësi e të hyrave devizore në turizëm në vitet e fundit përkon me masat dhe aktivitetet e ndërmarra gjatë viteve të kaluara nga i gjithë sektori turistik në vend. "Njëra nga aktivitetet që e realizon Agjencia për promovim dhe mbështetje të turizmit në Republikën e Maqedonisë në drejtim të promovimit të Maqedonisë në shtetet e huaja është intensifikuar dhe realizuar përmes targetimit të fushatës së marketingut që është plasuar në target vendet. Me këtë lloj të aktivitetit të marketingut, Agjencia për turizëm ka reklamuar potencialin turistik të vendit përmes kapaciteteve turistike, lokacione, pamje, histori, kulturë, traditë dhe gastronomi", thonë nga Agjencia.

Rritje e eksportit
për 26.5 për qind

Shkup, 6 gusht - Eksporti i mallrave nga Maqedonia në gjashtë muajt e parë të vitit shënon rritje prej 26,5 për qind. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistikë, vlera e mallit të eksportuar për periudhën janar-qershor të vitit 2018 është 3.323.298 mijë dollarë amerikanë. Vlera e mallit të importuar në gjysmëvjetorin e parë është 4.441.172 mijë dollarë amerikanë dhe shënon rritje prej 24 për qind. Deficiti tregtar, në periudhën janar-qershor të vitit 2018, është 1.117.874 mijë dollarë amerikanë. Mbulimi i importit me eksportin, në periudhën janar - qershor të vitit 2018, është 74,9 për qind. Sipas vëllimit të përgjithshëm të këmbimit të jashtëm tregtar, Republika e Maqedonisë më së shumti ka tregtuar me Gjermaninë, Britaninë e Madhe, Greqinë, Serbinë dhe Bullgarinë.

ULEN RENDIMENTET E GRURIT

KOSTOJA NUK E
ARSYETON PRODHIMIN

Bujqit që prodhojnë grurë si kulturë strategjike për shtetin gjenden në pozitë shumë të rëndë dhe janë mjaft të dëshpëruar nga situata. Ato nuk mund të mbulojnë harxhimet, nuk mund të planifikojnë të ardhurat dhe prodhimtarinë dhe mendojnë bile edhe të heqin dorë nga prodhimtaria e grurit. Andaj kërkojmë që në bazë të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural, në këto kushte kur harxhimet prodhuese janë më të larta se çmimi i tregut, shteti të realizojë grumbullim intervenues

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 6 gusht - Të mbjellat me grurë këtë vit janë për afër 30 për qind më të ulëta në raport me vitin e kaluar. Gjithashtu sivjet pritet edhe më pak rendimente të grurit më një mesatare prej 200 deri 250 mijë tonë grurë. Bile, të dhënat statistikore tregojnë se në periudhën e kaluar 25-vjeçare janë zvogëluar rendimentet e grurit për afër 35 mijë tonë. Sipas Entit të Statistikës, në vitin 1991 në Maqedoni janë prodhuar 340.747 tonë grurë, ndërsa 25 vjet më vonë janë prodhuar 306.433 tonë grurë. Fermerët ankohen se rritja e madhe e koston së prodhimtarisë së grurit i demotivon të merren me mbjelljen e grurit, ku për shembull - në vitin 1994 një kilogram grurë është grumbulluar me 12.6 denarë së bashku me transportin, ndërsa nafta nuk ka kushtuar as çereku i euros apo 17 denarë, ndërkohë sot nafta kushton afër 1 euro, kurse gruri grumbullohet me 7-8 denarë.

Nga Federata e Fermerëve të Maqedonisë thonë se prodhimtaria kontraktuese duhet të fillojë të funksionojë midis bujqve dhe mullistëve. Kërkohet edhe vendosja e masës së grumbullimit intervenues të grurit dhe çmimi prodhues prej 12 denarë për kilogram për grurin. Në të kundërtën, nga shoqata më e madhe e bujqve në Maqedoni thonë se edhe më tej do të ulen fushat e mbjella me grurë, që për pasojë - do të sjellë import edhe më të madh të grurit dhe miellit në shtet dhe me këtë, do të bëhemi të varur nga importi i grurit si ushqim themelor në shtet.

Bujqit që prodhojnë grurë si kulturë strategjike për shtetin gjenden në pozitë shumë të rëndë dhe janë mjaft të dëshpëruar nga situata. Ato nuk mund të mbulojnë harxhimet, nuk mund të planifikojnë të ardhurat dhe prodhimtarinë dhe mendojnë bile edhe të heqin dorë nga prodhimtaria e grurit. Andaj kërkojmë që në bazë të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural, në këto kushte kur harxhimet prodhuese janë më të larta se çmimi i tregut, shteti të realizojë grumbullim intervenues, thonë nga Federata e Fermerëve.

"Ne kërkojmë që çmimi grumbullues

të jetë 12 denarë për kilogram që do të realizohet ngjashëm si në Serbi, ku shteti realizoi të grumbullimit intervenues të grurit gjatë korrjes me çmim të definuar. Vetëm në këtë mënyrë mund të kemi stabilizim të tregut. Njëherazi, bujqit duhet të kenë marrëveshje me grumbulluesit, të dinë çka prodhojnë dhe për çfarë çmimi", thotë anëtari i Këshillit Drejtues të Federatës së Fermerëve të Maqedonisë, Memet Sinani.

Nga ana tjetër, vlerësohet se edhe moti i keq me breshër, vërshime dhe të tjera kanë ndikuar në uljen e rendimenteve të grurit.

"Korrja është kah fundi, ndërsa ne gjendemi në situatë të palakmueshme për shkak se çmimi i prodhimit është më i ulët se ai prodhues. Nga Ministria e Bujqësisë kanë theksuar se çmimi prodhues është 9.14 denarë, ndërsa nga ana tjetër çmimi grumbullues lëviz prej 7 deri më maksimum 8.5 denarë në Pellagoni", thotë Stevançe Ordanovski nga Pelagonia. Nga ana tjetër, Ministria e Bujqësisë me një shumë prej katër milionë euro, me rritjen e subvencioneve për grurin e prodhuar dhe të dorëzuar do të ndihmojë si prodhuesit vendor të grurit dhe mullistët.

"Çdo grumbullues i grurit i regjistruar

në regjistrin e grumbulluesve që do të blejë grurë vendor të korrjes së vitit 2018 dhe atë më së voni deri më 15 shtator, do të fitojë subvencion prej një denarë për një kilogram grurë. Një hap i tillë pritet të nxisë edhe prodhimtarinë e kontraktuar dhe të përmirësojë konkurrencën e industrisë vendore të miellit. Pritet që për këtë masë të përkrahjes të ndahen afër një milion euro apo 70 milionë denarë, duke marrë parasysh se grumbullimi i grurit në mesatare është 70 mijë tonë", thonë nga Ministria e Bujqësisë. Pritet që deri më 15 gusht të përfundojë edhe blerja e 13 mijë tonë të grurit vendor për nevojat e rezervave shtetërore.

Risi është se sivjet për herë të parë, lejohen edhe sasi apo "lote" më të vogla, ndërsa bujqit mundën në mënyrë të drejtpërdrejtë a shesin grurin tek rezervat shtetërore. Ekzistojnë 10 njësi grumbullimi prej nga 100 tonë dhe tre njësi grumbullimi prej nga 4000 tonë. Masat e fundit pritet të ndihmojë grumbullimin e grurit vendor dhe të nxisë edhe çmimin më të volitshëm grumbullues. Masat e lartpërmendura, dalin pas analizave në sektorët e Ministrisë së Bujqësisë dhe më shumë takimeve që janë mbajtur me prodhuesit e grurit dhe grumbulluesit e grurit apo mullistët.

BUJQIT E PËRGËNJESHTRONJË MINISTRINË:
ÇMIMI I GRURIT MAKSIMUM 8.5 DENARË

Nuk është e saktë se çmimi blerës i grurit lëviz prej nëntë deri në 10,5 denarë për kilogram siç kumtoi Ministria e Bujqësisë. Nuk kemi takuar deri tani dikë të paguajë më shumë se 8,5 denarë me TVSH, reagojnë sot prodhuesit. Ata druajnë se për shkak të llogaritjeve të tilla të ndryshme të Ministrisë, nuk do të marrin përkrahje shtetërore si kompensim për dallimin mes çmimit prodhues dhe shitës, që ishte rast në dy vitet paraprake. Njëherësh mbeten në qëndrimin se çmimi blerës duhet të jetë dhjetë deri në 12 denarë për kilogram. "Nuk e di prej ku i ka këto të dhëna MBPEU. Dje bisedova me prodhuesit e Prilepit, Manastirit, Ovçe Poles. I dëgjova edhe përfaqësuesit e Lidhjes së bujqve, shoqatës rajonale "Klas", Federatës kombëtare të fermerëve, shoqatës "Ovçepolski farmer". Të gjithë kanë pothuajse deklarata identike për çmimet e grurit. Prej shtatë deri në tetë denarë është çmimi në terren, pavarësisht llojit të pagesës dhe cilësisë. Nuk kemi takuar deri tani dikë të paguajë më shumë se 8,5 denarë me TVSH. Bisedova edhe me mullistët, ata deri tani nuk kanë blerë grurë nga bujqit për më shumë se 8,5 denarë", deklaroi për MIA-n kryetari i Asociacionit të Bujqve, Eftim Shaklev. Sipas tij, 10,5 për qind është çmim joreal dhe mund ta japë, nëse shet, vetëm KB Pellagonia dhe atë të mullinjtitë e tij, por ajo nuk ka kurrfarë ndikimi ndaj formimit të çmimit blerës për bujqit.

POROJI I ZHGËNJYER NGA PUSHTETI

VIJNË, PREMTOJNË DHE NUK REALIZOJNË

Po mbushen një vit, respektivisht tre vite që kur ky fshat është vizituar nga shumë delegacione qeveritare, por situata në teren mbetet e njëjtë. Banorët janë të irrituar dhe thonë se nuk presin më asnjë ndihmë nga askush



tretërve të lumenjve edhe atë të lumit Shkumbin, lumenjve në fshatrat Reçicë e Madhe dhe Reçicë e Vogël, si dhe lumin e fshatit Poroj, tashmë është shpallur dhe procedurat për mbarimin e këtij vendimi janë nga fundi. Kështu, sipas këtij vendimi, nga Buxheti i Komunës janë ndarë 5 milionë denarë që parashihen për pastrimin e shtretërve të lumenjve, ndërkohë që në procedurë e sipër është dhe plani aksional mbi rregullimin dhe pastrimin e shtretërve të lumenjve për të cilin plan janë ndarë mjete nga Ministria e Ambientit Jetësorë dhe Planifikimit Hapësirë në vlerë prej 5 milionë denarë, por që sipas vendimit të ministrisë, ky plan aksional pritet të fillojë realizimin diku në muajin tetor kur edhe është paraparë pastrimi i shtretërve të lumenjve në mbarë vendin”, thotë Arsim Nuredini nga Komuna e Tetovës.

Vërshimi i lumit të Porojit kësaj radhe nuk kishte dëme më të mëdha nga ato të zakonshmet, por shkaktoi vetëm probleme në një pjesë të fshatit duke dëmtuar një urë dhe dëme në bujqësi. Banorët shprehen se funksionarët vijjnë vetëm kur ndodhin vërshimet, japin premtime të mëdha dhe në terren nuk realizojnë asgjë, duke i lënë në mëshirë të fatit. Madje, banorë tashmë edhe kanë hequr dorë edhe nga protestat, sepse zhgënjimi tek ata është i madh.

Kërkesa kryesore e tyre është rregullimi i digave përgjatë këtij lumi, kërkesë kjo që është adresuar edhe tek Qeveria edhe tek komuna, por vetëm zhagitet dhe nuk realizohet. Bile, edhe përgjigje se do bëhet apo jo, nuk ka.

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 6 gusht - Tre vite më parë, kur disa vendbanime të Tetovës ishin përfshirë nga vërshimet që morën me vete edhe viktimë në njerëz, autoritetet qendrore dhe ato lokale nuk gjetën mënyrë për të parandaluar vërshime dhe përmbajtje të reja. Pikërisht tre vite më pas, në fshatin Poroj sërish kishte frikë që situata të del jashtë kontrollit. Sipas një retrospektive, në këtë fshat pothuajse nuk ka ngelur pa ardhur asnjë funksionarë më i lartë shtetërorë në nivel kryeministrash. Ish-kryeministri Nikolla Gruevski dikur kishte paralajmëruar se do të sanohen dëmet dhe do të intervenohet që situata të këtilla të mos përsëriten. Po ashtu, në vitin 2017 në këtë fshat kishte ardhur edhe kryeministri i ri Zoran Zaev, për të parë nga afër vërshimet duke premtuar se Qe-

veria është në dispozicion që të ndihmojë edhe në sanimin, por edhe në parandalimin duke premtuar ndërtimin e digave. Në delegacionin e tij ishte edhe kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi dhe zëvendëskryeministri Hazbi Lika. Tashmë po mbushen një vit, respektivisht tre vite që kur ky fshat është vizituar nga shumë delega-

cione qeveritare, por situata në teren mbetet e njëjtë. Banorët janë të irrituar dhe thonë se nuk presin më asnjë ndihmë nga askush.

“Si Bashkësi Lokale më nuk kemi arsye përse t’i pranojmë sepse premtimet e tyre kanë qenë shumë të mëdha. E vërtetë është se diçka të vogël kanë bërë, por është minimale ajo në krahasim me

kërkesat tona. Ne kërkojmë zgjidhje dhe jo vetëm sanim”, deklaroi Sulejman Ramadani, kryetar i Bashkësisë Lokale të Porojit. Nga Komuna e Tetovës thonë se procedura për furnizime publike për pastrimin e lumenjve është në rrjedhë e sipër.

“Vendimi për shpalljen e furnizimit publik për pastrimin e sh-

ALARM I ISHP-së

PËR NJË MUAJ JO TË PLOTË, 25 TË PREKUR NGA FRUTHI NË DIBËR

Shkup, 6 gusht - Njëzet e pesë të prekur nga fruthi, bashkë me 3 gushtin janë regjistruar në territorin e Dibrës, publikoi në uebfaqen e saj Instituti për Shëndet Publik i Republikës së Maqedonisë. Dhjetë rastet e para ishin regjistruar më 17 korrik, kur ishte shpallur epidemia e fruthit në rajonin e Dibrës. Nga ISHP potencojnë se të sëmurët janë të moshës prej shtatë muaj deri në 45 vjeç. Nga numri i përgjithshëm i të prekurve, 44 për qind janë pjesëtarë të popullatës rome, 40 për qind shqiptarë, tetë për qind turq, katër për qind (një i sëmurë) të kombësisë maqedonase dhe për një person nuk ka të dhëna. Nga të prekurit me epidemi për 16 persona ka konfirmim laboratorik, ndërsa te nëntë raste është konfirmuar

Nga ISHP rekomandojnë të vazhdohet me kontrollin epidemiologjik të përforcuar të etheve në Dibër, por edhe në qytetet e tjera dhe çdo rast i dyshimtë i fruthit i cili i plotëson kriteret e definimit të rastit nevojitet të hulumtohet dhe të testohet në laborator

lidhja epidemike. Nga rastet e konfirmuara laboratorike, 68,8

për qind nuk janë të vaksinuar ose jo komplet të vaksinuar, ndërsa 31,2 për qind janë vaksinuar me dy doza të vaksinave kundër fruthit. Nga ISHP informojnë se me qëllim që të zvogëlohet mundësia për përhapjen e sëmundjes është zbatuar hulumtim epidemiologjik për çdo rast veçmas të fruthit nga ana e epidemiologëve lokal, është kontrolluar statusi i vaksinave të gjithë personave të sëmurë dhe kontaktet e tyre, ndërsa në kontaktet e personave të sëmurë të cilët nuk janë vaksinuar ose nuk janë vaksinuar komplet u rekomandohet vaksinimi me MRP vaksinë, deri në kompletimin e statusit të vaksinës, sipas moshës. Gjithashtu, është kontrolluar përfshirja e vaksinave me MRP vaksinë në territorin e Dibrës,

personat që nuk janë vaksinuar janë thirrur për vaksinim, është përforcuar kontrolli epidemiologjik i etheve i ndjekur me puçrra të fruthit, çdo rast i dyshimtë i fruthit është testuar në laborator, është ndarë material edukativ-informativ i punonjësve shëndetësor për mbrojtjen primare shëndetësore, në kopshtet e fëmijëve, ndërsa është publikuar edhe material edukativ në uebfaqen e ISHP-së, me qëllim që njerëzit të cilët shkojnë në pushime verore në destinacionet ku ka epidemi nga fruthi të jenë të vetëdijshëm për rreziqet, derisa fëmijët e tyre ose ata nuk vaksinohen kundër fruthit. Nga ISHP rekomandojnë të vazhdohet me kontrollin epidemiologjik të përforcuar të etheve në Dibër, por edhe në qytetet e

tjera dhe çdo rast i dyshimtë i fruthit i cili i plotëson kriteret e definimit të rastit nevojitet të hulumtohet dhe të testohet në laborator. Shërbimet epidemiologjike pranë qendrave për shëndet publik duhet t’i njoftojnë mjekët amë/pediatër t’i paraqesin të gjitha rastet e dyshimta (ethe) deri te shërbimi epidemiologjik i Qendrës kompetente për shëndet publik në afat prej 24 orëve nga konfirmimi i diagnozës ose dyshimi, ndërsa më së voni për 24 orë nga dyshimi i konfirmuar i fruthit të paraqesin regjistrim për sëmundje/vdekje nga sëmundja ngjithëse deri te shërbimi epidemiologjik i Qendrës kompetente për shëndet publik dhe sërish regjistrim të ri pas konfirmimit laboratorik të sëmundjes.

dhimshpirte ishin ato thirrjet : "Komora gazi për shiptarët?!" Atëbotë s'kish FB, do e kisha bo një postim tip FENDE, tip PORDHE, e do kisha vetknaqur krenarinë time naïve ! Pa pa pa , dikush do ma kish mburr shpinën , e unë do kisha flejt po me krenari. Oiiiiiii çka l paskam bë vetes, një KRENARE DYTANE !!!! Hej, si duket krenaria e dytësorit, e vartësit...?!?!? Duket e atillë që nuk e ka knaqur gufimin e rinisë, asaj rinie që lypke ardhmërinë e njejt e t'bardh e plot vision si bashkëqytetari im maqedonas. Isha/e/i suprimuar edhe nga të suprimuarit. Dyfish e suprimuar! Përse s'kam rrendur të reagoj , pyetem dhe më vërshojnë do arsyetime të papërcaktuara qartë , të pa cilësime mirë...del që i kam lejuar , i kemi lejuar pra ! Po pra, ky është ai mentaliteti vartës që e përmenda, dytësori !

5. Mentalitet Vartës ose Shpellar (madje i jap të drejtë Zimerit, sado dhemb!) , tanimë është bo rrafsh njilloj: "the World is Flat"...Jena barazu në mediokritet politik e lidershipi kulturor! Shiptar, shqiptar ose albanec përsëri do rreshtohemi pas referndumit mbi ndërimin e emrit të shtetit e do i mbajmë frymën shtetit, për të satën herë! Kjo nuk është sakrificë jo, do duhej të ishte kulturë shtetare . Por...nuk i ngjan të tillës fatkeqësisht, sepse kultura shtetare do mentalitet fisnikësh e avangardësh. A e sheh miku im se cfar krenarie primordiale ke ushqyer tan' jetës tande!? Ti ke trashëguar gjendjen e të suprimuarit kolektiv dyfish, dhe e pritshme është që përsëri e me indolencë t'a kapërcesh fashizmin e tjetrit ndaj teje, por ma së keqi asht se ke humbur shijen tanimë edhe për integrimin në NATO...thjesht, do e bësh votën – se duhet bërë, por jo se paske kultivu kulture shtetane-sh! Bashkë me mua!

6. Koha e krenarisë imagjinare shkoi. Vrite krenarinë e tillë inhbuse për brendinë tande! Shteti abuzon me vartësit e me krenarët imagjinarë! Prandaj, mos abuzo me veten më! Pozita politike e shqiptarëve i jep simptomat e një karakteri kolektiv politik të quajtur "agresivitet pasiv", ose tregon një lloj sjelljeje ose personaliteti të karakterizuar nga rezistenca e tërthortë ndaj kërkesave të të tjerëve dhe shmangia e konfrontimit të drejtpërdrejtë, prandaj bëhemi vartësit të vazhdueshëm ndaj vendimit të tjetrit! Logjika e politikanit shqiptar sot, para detyrës të NATOS , ndryshon nga ajo e etnisë së tjetrit : ata i dëgjoj të thonë : KE NE BIDE!...ndërsa ne duhet të fillojmë të themi: NE JEMI!

7. Vartësi asht Steril, Prijësi asht pjellor!

(Autorja është kolumniste e rregullt e gazetës KOHA)

Të bashkëpunojmë me diasporën

Diasporë shqiptare ka në Austri, Holandë, Luksemburg, Danimarkë, Suedi, Belgjikë, Norvegji, Finlandë, Islandë, Francë dhe në shumë vende të tjera të botës së largët, si në SHBA, Kanadë, Australi, vetëm në Zvicër dhe Gjermani ka mbi 400.000 shqiptarë.

Meqë në Maqedoni nuk ka Ministri konkrete për Diasporën, por ministër pa resor që angazhohet edhe për diasporën, të drejtën për menaxhimin me shtetasit jashtë Maqedonisë e kanë edhe ministrinë e ndryshme, por më tepër Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Pushtetit Lokal, Agjencia për Emigracion, Ministria e Ekonomisë, Banka Popullore e Maqedonisë, përgjithësisht e kanë për obligim të shpalosin plane të reja strategjike, që të gjejnë modalitete sa më efikase, që ti tërheqin sa më afaristë nga diaspora. Andaj komunave në aktivitetet e tyre programore, ju takon, si risi të themelojnë organet e tyre shtesë - Sektorë për bashkëpunim me diasporën, apo Program i shoqërisë civile për bashkëpunim me Diasporën. Për një gjë të tillë duhet marr sugjerime dhe rekomandime nga Ministrinë e Pushtetit lokal.

Të vetëdijsohemi për një bashkëpunim në diasporë, sepse sot në komunat tona, është imamente të veprohet për integrimin e mërgimtarëve tanë jo vetëm në sferën kulturore, etnike, arsimore, shkencore, profesionale, sportive, por ata të integrohen edhe në sferën e ekonomisë me zanafillë në nivel lokal.



Mërgimtarëve duhet ofruar kreacion Programesh për riintegrim në shoqërinë e vendit, për afinitetet e tyre, cilësitë, për inovacione në ekonomi, tregti e turizëm, për gjithë ata që shprehin vullnet dhe interes të kthehen nga diaspora...

Faktikisht të kërkohet prej sektorëve civile komunale, për informim me të dhëna statistikore - për afaristët tanë të njohur në diasporë, e që janë nga Maqedonia, për vizitën e tyre nga kryetarët e komunave nga Maqedonia, duke u afruar mërgimtarëve plane strategjike, ideo-projekte konkrete për investimin e tyre në vend, për një progres gjithë ekonomik.

Pozitive është të vizitohen, të komunikohet me politikanët tanë shqiptarë në diasporë, me kryetarë komunash, kryetarë të OJQ-ve në diasporë, me shkencëtarë, me ato që kanë përvojë të lakmueshme me sukseset e tyre në sferat ndryshme të jetës. Të njoftohemi me

ndonjë ide reformiste të nevojshme, për implementimin e saj pozitiv-ekonomik, që të merret si risi këtu për progresin e komunave tona në Maqedoni. Kur dihet se ekziston ligji për një liri veprim të tillë për bashkëpunim me diasporën, birësim mes komunash të ndryshme në diasporë, bile edhe për themelim të ndonjë, ndërmarrje të përzier (të përbashkët) për biznes të përbashkët(komunë - afarist i diasporës) po për një gjë të tillë kërkohet vullnet, guxim dhe përvojë menaxhimi politiko-ekonomik, i kreut - kryetarë komune. Me qëllim që mërgimtarët tanë, të kyçen në jetën publike e politiko-ekonomike të përbashkët në cilën do komunë të Maqedonisë, qoftë rurale apo urbane. Lypet bashkëpunim dhe të jemi transparent me mërgimtarët aktiv, pozitiv, magnatë, të këmbëhen mendime lidhur me potencialet ekono-

mike, resurset natyrore kreative , që ka vendin në nivel komunal, për kapacitetet e resurseve natyrore që ofron një komunë për zhvillim të degëve të ndryshme ekonomike, për pasojat që la tranzicioni, për mosmundsimin ekonomik të vendit të shumë pasurive nëntokësore të vendit, dhe për mundësitë dhe interesat e tyre për investim për inovacione në ekonomi.

E gjithë kjo përpjekje të jetë në opsionin: birësim i ndërmarrësve, afaristëve, përfaqësuesve qeveritar, në bashkëpunim me partnerë nga diaspora, i cili aktivitet po çalon me decenie dhe nuk është i kënaqshëm në nivel republikan e qeveritar. . Mu nga mos neglizhenca, ose pasiviteti i një bashkëpunimi të tillë në relacionin pushtet lokal- diasporë, porse nuk ka rezultate aq sa duhet. Në këtë segment ekonomik, me arsyen; ose nuk dimë të menaxhojmë, apo nuk kemi nevojë për reforma ekonomike për një standard më të lartë të qytetarëve në përgjithësi.

Obligim shoqëror dhe qeverisës është ti qasemi zgjidhjes së interesave të mërgimtarëve dhe nevojave të tyre bashkëkohore, së paku në nivel lokal, qoftë kur ai të shpreh interes për themelim së paku edhe të një mini-ndërmarrjeje. Apostafat t'u ndihmohet mërgimtarëve që duan të kthehen për investim në vendlindjet e komunat e tyre, Mërgimtarëve duhet ofruar kreacion Programesh për riintegrim në shoqërinë e vendit, për afinitetet e tyre, cilësitë, për inovacione në ekonomi, tregti e turizëm, për gjithë ata që shprehin vullnet dhe interes të kthehen nga diaspora, qoftë për bashkëpunim në të gjithë sferat ekonomike, tu ofrohen kushte dhe oferta të volitshme për adaptim në ekonomin e vendit, gjë që do ishte një relaks për përmirësimin e ekonomisë së vendit.



Nga
Vebi RUSTEMI

Marrëveshja e Dojranit dhe laboratorit IRJM

Marrëveshja e Ohrit u mbajt në vitin 2001. Sa fituam e sa humbëm, sa duhesh-te të fitojmë e sa s'duhesh-te të humbim, nuk është koha dhe vendi. Por e di se kompromis është zgjidhje që arrihet e me të cilën të dy palët janë të pakënaqur. Nga kjo perspektivë e qartë është se hymë në kurth dhe politikëbërësit e Kumrovecit fituan në tavolinë falë përvojës të tyre apo falë papërvojës tonë. Një fitore interesante është si arritën ta zhdukim dokumentin origjinal të marrëveshjes, ndërsa humbja jonë është si nuk arritëm ta shndërrojmë këtë marrëveshje në nene dhe ligje. Marrëveshja e Prespës u mbajt në vitin 2018. Nga tre këndvështrime duhet analizuar ky problem, e para fak-



Disponimi i shqiptarëve është i dëshmuar në shumë anketa dhe s'ka dilemë për këtë, por opozitën e vërtetë shqiptare e shqetëson Marrëveshja e Prespës ku në mënyrë tinëzare tentohet të depersonalizohet dhe të shkombëtarizohet t popullata shqiptare

strukturat euroatlantike, e dyta, faktori maqedonas nën petkun e qytetarizmit nga pozita dhe nën petkun e pansllavizmit nga opozita tenton të ruaj pozitën e agait në këtë shtet dhe e treta, faktori shqiptar, e përfaqësuar nga pozita, e cila nën petkun e integrimi dhe vetëmbrojtjes është e gatshme të sakrifikojë identitetin kombëtar dhe gjithçka që e përcjell atë e nga ana tjetër opozita shqiptare, qëllimisht e gjymtuar dhe e anashkaluar nga premieri i shtetit dhe bashkëpunëtorë e tij duke harruar për ndikimin e saj në popullatë sipas anketa të reja nga institucione relevante. Është e pafalshme që edhe kjo gjeneratë e politikanëve të hyj në kurthin e njëjtë dhe problemet nacionale të mbeten të porealizuara ose gjysëm të realizuara për të cilat do duhesh-te të mbahet edhe një marrëveshje, diku në vitin 2035, kësaj radhe Marrëveshja e



Nga
Dr. Bekim TATESHI

Dojranit në të cilën "qytetarët që në shtëpitë e tyre flasin gjuhë që dallon nga maqedonishtja dhe janë mbi 50% të popullatës së përgjithshme do duhet ta flasin atë gjuhë deri te dera e oborrit".

Laboratori eksperimental i quajtur Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë do duhet të mbyllet dhe jo të rindërtohet me emër tjetër e me probleme të njëjta apo më të mëdha që do ishte barrë për ndërkombëtarët dhe e rrezikshme për shtetasit e saj dhe shteteve për rreth. Integrimi i këtij laboratorit në NATO dhe BE është urgjent dhe i pashmangshëm. Jemi në prag të dyerve të këtyre shtëpive të mëdha dhe ky rast është i papërsëritshëm. Disponimi i shqiptarëve është i dëshmuar në shumë anketa dhe s'ka dilemë për këtë, por opozitën e vërtetë shqiptare e shqetëson Marrëveshja e Prespës ku në mënyrë tinëzare tentohet të depersonalizohet dhe të shkombëtarizohet popullata shqiptare. Deputetët shqiptarë në parlamentin e IRJM-së e kanë për obligim dhe detyrë që çdo shqiptari t'ja tregojnë të vërtetën se çka do ndodh me shqiptarët dhe shqiptarizmin në shtetin e ri, Republika e Maqedonisë Veriore.

“CALVERT JOURNAL”: KADARE, NDËR DHJETË AUTORËT E REKOMANDUAR


Revista angleze “Calvert Journal” ka botuar listën e dhjetë shkrymtarëve që rekomandohen për tu lexuar e që vijnë nga Ballkani. Me ndarjen e Jugosllavisë, siç shkruan Hannah Weber për CJ, u shkaktua lëvizje edhe në identitetin e Ballkanit, por kjo sidoqoftë ka ndihmuar në lulëzimin e një letërsie bashkëkohore në këtë anë

të kontinentit evropian.

Ajo ka rekomanduar dhjetë autorë nga Ballkani që duhet lexuar, duke nisur nga elegjitë për Kosovën deri te mitet pagane ballkanike. Kësaj liste nuk i mungon shkrymtari Ismail Kadare, dhe sidomos libri “Tri këngë zie për Kosovën”.

Krahas Kadaresë, në listë janë

edhe Dubravka Ugresic nga Kroacia, Ioana Parvulescu nga Rumania, Miroslav Penkov nga Bullgaria e Herta Muller nga Rumania, mes të tjerëve, shkruan KultPlus. i Kadaresë përbëhet nga tri tregime: Lufta e vjetër, Zonja e madhe dhe Lutje mbretërore. Të tria këto tregime bëjnë fjalë për betejën e Kosovës më 1389.



Kur Ali Podrimja i shkruante Dritëro Agollit

“E, unë ku të prehem?” – një shpirt i shqetësuar poeti atdhedashës, sa herë duhet ta ketë përsëritur këtë pyetje. E kur Kombi është në duart e bajraktarëve, pyetja është e thekshme, e dhimbshme. Me kë mund të ndante këtë shqetësim i madhi Ali Podrimja, përveçse me të ngjashmin dhe “vëllain” e tij poet dhe atdhetar, Dritëroin.

— I dashur Dritëro, Ç’të bëj? Në veri ma grabisin Kosovën sërëbët, në jug maqedonët, në Perëndim malazezët...Vendlindja e Azem Shkrelit nuk është më nën jurisprudence të Kosovës, po të Malit të Zi, ndërsa varri i Fehredin Cungës gjendet nën jurisprudence të Serbisë... E, unë ku të prehem? Shqipëria, mund të më ofrojë azil? Kam rënë në hall me bajraktarët e kombit. Nuk di ç’të bëj?... Të qafon yt vëlla, Ali Podrimja 26 shkurt 2003, Ulpianë

PANAIRI I LIBRIT NË ULQIN, BASHKON BOTUESIT DHE PUSHUESIT

Arti dhe kultura, janë jo vetëm ura lidhëse mes popujve, por edhe mjet për promovimin e tyre.

Dhe këtë fundjavë, Ulqini, dashmirës i aktiviteteve kulturore, multikulturës dhe diversitetit, mikpritur Panairin e Librit, “Ulqin 2018”.

I nisur që në vitin 2001, Panairi i Librit “Ulqin 2018”, i cili mbahet nga data 3 deri më 8 Gusht në shëtitoren e Plazhit të Vogël, u organizua nën kujdesin e Komunës së Ulqinit, falë edhe bashkëpunimit të Institutit të Librit dhe të Promocionit me Organizatën Turistike të Ulqinit dhe me Qendrën për Kulturë të Ulqinit, Mali i Zi.

Në ceremoninë çeljes së këtij edicioni, morën fjalën drejtori i Organizatës Turistike të Ulqinit, Fatmir Cjeka, drejtorja e përgjithshme e Institutit të Librit dhe



Promocionit, Irena Toçi, shkrymtari Namik Dokle, ministri i Kulturës së Malit të Zi, Aleksandar Bogdanoviç, zv.ministri i Turizmit dhe i Mjedisit të Shqipërisë, Hajrullah Çeku dhe kryetari i Komunës së Ulqinit, Loro Nrekiq.

Një event i mirëpritur nga pushues dhe dashmirës të librit dhe që përcjell mesazhin e bashkëpunimit në rajon, edhe këtë vit bëri bashkë 45 botues nga Tirana, Shkoder, Ulqini, Podgorica, Prishtina, Shkupi, Tetova e Gostivari duke prezantuar me qindra botime të reja të realizuara brenda këtij viti.

Drejtorja e përgjithshme e Institutit të Librit dhe Promocionit, Irena Toçi u shpreh se ky panair mban në gjirin e vet punën e gjithë këtyre

botuesve, që në mënyrë të përkushtuar, nuk ju ndan këtij panairi për 18 vjet me radhë. “I falenderoj nga zemra që sjellin në qytetin e Ulqinit vit pas viti, botimet e tyre më të mira duke u krijuar mundësi të gjithë pushuesve dhe qytetarëve të Ulqinit që të mund ti njohin dhe pse jo ti lexojnë gjatë ditëve të tyre të pushimit”, u shpreh ajo.

Shkrymtari Namik Dokle, u shpreh se rëndësia e librit kuptohet vetëm nga ata që e lexojnë. Sipas tij, bota nuk mund të ishte kjo që është pa librin, pa kulturën, pa marrëdhëniet midis njerëzve popujve dhe shteteve.

Ministri i Kulturës të Malit të Zi, Aleksandar Bogdanoviç, vlerësoi mbajtjen e këtij Panairi, që sipas tij, krijon një tjetër dimension të bashkëpunimit në rajon.

Përfundojnë xhirimet e filmit “Shpata prej Druri”



Pas një punë intensive rreth dy muajshe në Kosovë, kanë përfunduar me sukses xhirimet e filmit “Shpata prej Druri”, me skenar nga Selman Kılıçaslan dhe me regji të Emre Konuk, regjisor i njohur turk i cili me filmin “Çirak” ka fituar çmime të shumta në festivalin ndërkombëtar dhe në ato në Turqi, përcjellë KultPlus. “Ikonë Studio me sukses ofroi të gjitha shërbimet e produksionit për këtë projekt, njëherëshit kjo dëshmoi që Kosova është e gatshme të ofroj shërbime produksioni edhe projekteve të mëdha filmike ndërkombëtare, me ekip profesional si dhe shërbime teknike. Ky projekt i përfunduar me sukses hap dyert e një bashkëpunimi me prokucionin Turk i cili realizon projekte të mëdha filmike ne Turqi dhe më gjërë”, shkruhet në postimin e Agon Ukës nga Ikonë Studio.

Uka tutje ka shtuar se ky produkt nuk do të ishte e mundur të realizohej sikurse mos të kishim përkrahjen e Institucioneve si dhe qytetarëve të Repu-

blikës së Kosovës.

“Ky shkrim bëhet që në mënyrën më të sinqertë të faleminderohen të gjithë ata që ndihmuan në realizimin e këtij projekt, dua në veçanti të faleminderoj ekipin e filmit, aktorët, Komunën e Mitrovicës, Komunën e Prizrenit si dhe Policinë e Kosovës”, shkruhet tutje në postimin e tij.

Ky film sjellë historinë e Hajdarit. Babai i Hajdarit i cili ka lindur në fshatin Krushë të Vogël të Kosovës, Hyseini si personi i vetëm që ka shpëtuar nga një masakër e madhe e serbëve në këtë fshat në luftën e vitit 1999, është zhdukur. Pas disa vitesh me vdekjen e nënës së tij, Hajdari mbetet i vetëm dhe kujdesjen e tij e marrin xhaxhai Nexhati dhe grua e tij Fatimja. Hajdar i cili braktis edhe studimet universitare në drejtimin e historisë për shkak të kushteve ekonomike, kishte filluar të ndiqte një shenjë me dëshirën për të gjetur babanë e tij.

Të gjithë aktorët e filmit janë kosovarë, ku aktori kryesor me rolin e Hajdarit është Florist Bajgora. Përveç tij, në kastingun e filmit ndodhen aktorët e njohur si Ylber Bardhi, Fiona Gllavica, Mensur Safqiu, Bislim Muqaj, Ilir Prapashtica, Astrit Kabashi, Vedat Bajrami, Irena Cahani, Ernest Malazogu, Artiole Hamdiju, Xhevdet Doda etj.

Për herë të parë producentët turq kanë xhiruar një film me gjuhë origjinale shqipe dhe me artistë nga Kosova, po në këtë vend.

Shfaqja “Gjymtimi” pjesë e Festivalit të Martin McDonagh

Shfaqja “Gjymtimi” e Teatrit Shqiptar të Shkupit me regji të Qëndrim Rijanit është përzgjedhur në programin e Festivalit Ndërkombëtar të Martin McDonagh në Perm të Ruisë. Regjisori i shfaqjes “Gjymtimi”, Qëndrim Rijani në një intervistë të mëhershme kishte thënë se teksti i McDonagh paraqet pasqyrim të realitetit të pranishëm edhe në këto hapësira, me të gjitha mangësitë dhe problematikat, me të gjitha gëzimet dhe hidhërimet. Rolet e kësaj shfaqjeje i interpretojnë aktorët e njohur të Teatrit Shqiptar, si: Adem Karaga, Amerins Nokshiqi dhe Luran Ahmeti. Në tekstet e McDonagh është i shprehur brutaliteti, si një prej formave më të njohura.



Ahmet SELMANI

SHQIPTARËT QË FRIKËSOHEN NGA GJUHA E TYRE

Teksa e shohim këtë realitet, vetvetiu pyesim: Vallë, kush na e ka fajin, ne që s'na bën përshtypje gjuha jonë amtare apo maqedonasit që nuk e zbatojnë atë në praktikë? Sigurisht është e turpshme dhe e dhimbshme kjo sjellje poshtarake dhe dyfytirane. Prandaj, duhet thënë fare troç: Kur vetë ne, bijtë e shqipes, siç na pëlqen të angërdufemi shpesh, nuk e respektojmë gjuhën tonë, atëherë si mund të na e respektojnë të tjerët? Jo, ore jo, shqipja nuk mbrohet me hipokrizi të harlisur, por me vepra konkrete. Mungesa e vetërespektit është sëmundje shumë e rëndë që po na e ha shpirtin.

Siç e dimë të gjithë, kohëve të fundit, çështja që ka të bëjë me zbatimin e gjuhës shqipe në mbarë qytetin e Shkupit, është bërë një temë jashtëzakonisht e nxehtë, duke i shqetësuar kështu shpirtërat e atyre të cilët prej kohësh e kanë patur si halë në sy. Me këtë rast, veçmas u vunë në shënjestër disa nga drejtorët e ndërmarrjeve publike, të cilët duket se qëllimisht e kanë heshtur problemin e dygjuhësisë, sikur të mos ekzistonte fare.

Prandaj, mund të thuhet se, efekti i parë mediatic që u arrit nga kjo luftë parimore, menjëherë u shënuar si një triumfalizëm spektakolar, megjithëse në esencë rezultati ishte tepër minimal. Kjo do të thotë se zbatimi i shqipes filloi detyrimisht me një thjeshtëzim të skajshëm nga ndërmarrja e transportit të qytetit, më në fund, duke e vendosur mbishkrimin dygjuhësh vetëm në autobusët e njëjës linjë, por me premtimin se një praktikë e këtillë do të ndiqej gradualisht edhe në të gjithë autobusët e linjave të tjera. Pavarësisht se deri ku arriti ky jetësim, e rëndësishme është të theksohet fakti se,

pikërisht nga kjo trysni e drejtë, ca njerëz bishtnues e shpirtngushtë, sado që me zemër të plasur, u detyruan ta ndryshonin qëndrimin e tyre në të mirë të gjuhës shqipe, ashtu siç i obligon ligji që ka të bëjë me përdorimin e gjuhëve.

Mirëpo, krahas tërë kësaj ecurie të ngadalshme e të mundimshme, gjithsesi është e udhës të trajtojmë edhe një gjë po kaq të ndijshme për sa i përket zbatimit praktik të kësaj gjuhe. Thjesht, tani doemos lypset që vëmendjen tonë ta përqëndrojmë edhe në anën e kundërt, përkatësisht te vetë shqiptarët si bartës dhe dalzotës të gjuhës amtare. Pra, çështja në fjalë ka të bëjë edhe me faktin se anashkalimi ose shpërfillja e gjuhës shqipe nuk është një zakon i ligët vetëm i maqedonasve, por, fatkeqësisht, është edhe indiferencë shumë e shëmtuar e vetë shqiptarëve. Dëshëm apo nuk dëshëm ne, pikërisht këtu qëndron zanafilla e problemit i cili gjithnjë mbulohejt lehtësisht me hipokrizi folklorike e patriotike.

Në qoftë se duam të kthjellohem dhe të mos e gënjejmë veten me veprime tepër paradoksale, patjetër duhet të pyesim haptas se si qëndron puna me zbatimin e shqipes nga vetë shqiptarët? Për të qenë të sinqertë deri në fund, kjo as që është shtruar ndonjëherë me seriozitetin e duhur. Më e keqja është se tani një sjellje e këtillë gati-gati edhe nuk na bën përshtypje fare. Ose, për shkak se jemi mësuar gjithmonë të arsyetohemi me atë retorikën banale se fajin na e kanë të tjerët, se na urrejnë, se nuk na duan etj.

Në gjithë këtë dyfytirësi kronike, është shumë e ndershme që

së pari ta pyesim veten tonë se ç'po bëjmë ne realisht për zbatimin e gjuhës shqipe, të paktën në ato mjedise ku jetojmë dhe ku jemi më kompakt. A thua, me çfarë mbishkrimesh na shfaqen para syve autobusët privat të cilët qarkullojnë çdo ditë, që në shumicën e rasteve janë pronë e shqiptarëve? E vërteta është e hidhur: ne i shohim fare mirë kur kalojnë mospërmas lagjeve apo katundeve shqiptare, pa e vendosur as edhe një shkronjë të vetme në gjuhën shqipe nëpër autobusët e tyre, të cilët i ngasin me aq zell e krekosje. Përderisa ata enden pa ngurrim gjithë ditën e lume, ne s'kemi si të mos i lexojmë mbishkrimet e ndryshme që i kanë vendosur kryesisht në maqedonisht dhe me alfabet cirilik, bie fjala: "Privaten avtobus", "Sajmishte – Karposh - Saraj i obratno" etj.. Përballë kësaj situatë shumë të pahijshme e të padrejtë, thujse askush nuk reagon, nuk e thotë asnjë fjalë të vetme, madje as që brengoset për dukurinë në fjalë.

Realitetin e këtillë kaq paradoksal e ilustron edhe shumë shembuj të tjerë që po na i verbojnë sytë. Në këtë mënyrë, po t'u hedhim një sy vetëm atyre dhjetëra e dhjetëra mbishkrimeve që ndodhen para dyqaneve, markeve, firmave, punishteve etj., nëpër komunat ku jetojmë dhe veprojnë shqiptarët, ku pothuajse nuk ka asnjë maqedonas, do të shohim fare mirë se situata bëhet akoma më e pakëndshme. Mjaf-ton edhe një shëtitje e shkurtër, për të lexuar mbishkrimet e shpeshta si: "Staklar", "Frizerski salon", "Bravar", "Berbernica", "Autolimar", "Autoelektricar", "Mehanicar", "Ap-



Në qoftë se duam të kthjellohem dhe të mos e gënjejmë veten me veprime tepër paradoksale, patjetër duhet të pyesim haptas se si qëndron puna me zbatimin e shqipes nga vetë shqiptarët? Për të qenë të sinqertë deri në fund, kjo as që është shtruar ndonjëherë me seriozitetin e duhur. Më e keqja është se tani një sjellje e këtillë gati-gati edhe nuk na bën përshtypje fare. Ose, për shkak se jemi mësuar gjithmonë të arsyetohemi me atë retorikën banale se fajin na e kanë të tjerët, se na urrejnë, se nuk na duan etj.

teka", "Kovaç", "Kebabçilnica", "Çajxhnilnica" etj. Vendosja e shkronjave të mëdha cirilike gati sa vetë trupi i pronarëve, flet qartë se sa hipokritë dhe inferiorë janë këta shqiptarë të cilët në mesin tonë shtiren si burra me sedër dhe me dinjitet, ndërkaq në mesin e maqedonasve bëhen palaço cirku. Te ne gojën e kanë plot patriotizëm e micsokolizëm, kurse te maqedonasit - plot përlulje e nënçmim.

Për të qenë ironia edhe më e madhe, ndonjëri prej këtyre pro-

narëve që i thotë vetes shqiptar, në ballkonin e shtëpisë së tij e ka vendosur edhe flamurin me shqiponjën dykrenare, por duke harruar i gjori se poshtë e ka ngjitur edhe mbishkrimin maqedonisht me shkronja cirilike. Nga ana tjetër, po ashtu, jemi dëshmitarë se ende ka nga ata shqiptarë që dokumentet e tyre të udhëtimit i nxjerrin vetëm në maqedonisht. Mjeranët e tillë rremenden se ashtu më mirë do ta kalojnë nëse i ndalon policia në rrugë apo nëse kanë nevojë për ndonjë punë administrative.

Teksa e shohim këtë realitet, vetvetiu pyesim: Vallë, kush na e ka fajin, ne që s'na bën përshtypje gjuha jonë amtare apo maqedonasit që nuk e zbatojnë atë në praktikë? Sigurisht është e turpshme dhe e dhimbshme kjo sjellje poshtarake dhe dyfytirane. Prandaj, duhet thënë fare troç: Kur vetë ne, bijtë e shqipes, siç na pëlqen të angërdufemi shpesh, nuk e respektojmë gjuhën tonë, atëherë si mund të na e respektojnë të tjerët? Jo, ore jo, shqipja nuk mbrohet me hipokrizi të harlisur, por me vepra konkrete. Mungesa e vetërespektit është sëmundje shumë e rëndë që po na e ha shpirtin.

Pa dashur të keqkuptohemi dhe, aq më pak, të bëjmë avokatin e dikujt, së pari fajin le ta kërkojmë brenda vetes sonë, e më pastaj do të kemi të drejtë që përgjegjësi të kërkojmë edhe nga të tjerët që jetojnë pranë nesh si bashkëqytetarë të këtij shteti të brishtë. S'do mend, në këtë rast mediat nuk do të bënin keq të merreshin edhe me këtë çështje kaq të neveritshme në mesin tonë. Sa keq kur vetë shqiptarët kanë frikë nga gjuha e tyre!

NDAHEN ÇMIMET "MUSLIM MULLIQT"

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka ndarë të hënën për herë të parë çmimet në fushën e arteve pamore "Muslim Mulliqi", ku çmimi Kombëtar për vepër Jetësore në fushën e arteve pamore post-mortum iu nda Muslim Mulliqit.

Ndërsa çmimi i dytë Kombëtar për veprimtari jetësore në fushën e arteve pamore iu nda akademik Xhevdet Xhafës, kurse çmimi i vjetor për të arriturat në fushën e artit pamor iu nda Fatmir Krypës.

Ndarjen e çmimeve e bëri ministri i kulturës, Rinisë dhe Sportit Kujtim Gashi, i cili tha se përmes këtyre çmimeve synojnë të ndihmojnë dhe motivojnë ata që merren me artin pamor.



ministri jemi të interesuar që ta mbështesim artin pamor. Ky çmim që jepet për here të parë sot është dëshmi që ne respektojmë njerëzit që punojnë me artin pamor", tha ai.

Çmimin e parë, në emër të famijes e mori gruaja e Muslim Mulliqit, Resmie Mulliqin e cila shprehi dëshirën e saj që një kjo iniciativë e ministrit Gashi të vazhdojë edhe viteve tjera. Ndërsa ministri e si-

guroi se çmimet e tilla do të shndërrohen në traditë. Dy çmimet e para kanë marrë shpërblime në vlerë financiare në vlerë prej 5 mijë euro, ndërsa çmimi i tretë në vlerë prej 3 mijë euro.

AGIM VINCA TESTAMENTI I ADEM DEMAÇIT

"Babai im, që s'ishte vetëm imi, baca Adem, vdiq i qetë", tha Shqiptar Adem Demaçi më 27 korrik 2018 në Prishtinë, në Kuvend. E si mund të vdiste ndryshe, pos i qetë, njeriu që ka kryer si askush tjetër detyrën e vet në jetë? "Do të jetë i qetë edhe në atë botë po që se Atdheu do të frymojë në Paqe e Liri ashtu siç deshë Ai, Baca Adem". Amin, Kosovë, Amen!

Strugë, 31 korrik 2018

TË PËRKRAHET MARRËVESHJA THAÇI-VUÇIQ

Derisa Server në një shkrim para disa ditësh ka kundërshtuar ashpër idetë për shkëmbime etnike të territoreve në mes Serbisë dhe Kosovës, ambasadori Petritsch ka befasuar me një koment që ka postuar në faqen e Serverit, duke bërë të ditur se ka njohuri të thellë për marrëveshjen që po negociohet në mes të Presidentit Thaçi dhe atij Vuçiq



FORCAT AJRORE TË SERBISË NISIN USHTRIMET NË NISH DHE NË JUG

Brenda kuadrit të trajnimit të rregullt fluturues, Forca Ajrore e Ushtrisë serbe do të nisë nesër stërvitjet në rajonin e Nishit dhe në jug të vendit. Kështu ka njoftuar sot Ministria e Mbrojtjes e Serbisë. Fluturimet e aeroplanëve serbë mbi këtë zonë do të zgjasin deri më 10 gusht, thuhet në deklaratë.

thënë se “analiza jote është e shkëlqyer, por se ka ardhur koha”, për siç thotë ambasadori i njohur austriak, “realizmin e ri në Ballkan”. Sipas Petritschit rreziku i vërtetë në Ballkan vjen nga ndikimi rus dhe hungarez në pasazhin medial, aventurat neo-Otomane të liderit boshnjak Bakir Izetbegovic, pastaj investimet arabe në Serbi dhe Bosnje si dhe mbi të gjitha “zgjerimi i shpejtë i ndikimit kinez në Evropën Juglindore”. Petritsch thotë se formati kinez “Evropa Lindore +1” dhe “Rrugë e Mëndafsh” që po promovohet nga Kina janë sfidat e vërteta për Ballkan dhe BE. Prandaj Petritsch thërret përkrahje për “linjën e marrëveshjes Thaçi-Vuçiq”. Ai shton se është “I vetëdijshëm me dhembje të thellë për dëshpërim” por se “kohërat janë duke ndryshuar”.

Në ndërkohë, Presidenti i Ko-

sovës, Hashim Thaçi, edhe një herë vazhdon të këmbëngul në qëndrimin e tij në raport me Serbinë dhe idesë së tij. Thotë se propozimi i tij për një zgjidhje paqësore me Serbinë tashmë është i qartë. “Nuk ka ndarje përgjatë vijave etnike, por po në korrigjimin e kufirit dhe njohje reciproke”, shkruan Thaçi në Twitter. Ndonëse, Thaçi deri vonë ishte kundër idesë për korrigjimin e kufirit me Serbinë, por tani, në çdo postim të tij në rrjete sociale e madje edhe në konferenca e mbështet këtë deklaratë të tij. Ideja e tij, u kundërshtua nga opozita dhe madje edhe nga partnerët e koalicionit. Ndërsa sot në një shkrim ekskluziv për Kohën Ditore, kryetari i Kuvendit Kadri Veseli ka dalë kundër idesë së presidentit Thaçi. “Në asnjë rrethanë, ndarja e Kosovës nuk do të jetë temë e dialogut”, thotë Veseli ndër të tjera.

Kosova ka bërë kompromiset e veta, nuk duhet të shkojë përtej Ahtisaarit

Albert Rohan, ish-numri dy në negociatat për statusin përfundimtar të Kosovës, i konsideron të tejkaluara dhe të rrezikshme idetë për ndarje ose shkëmbim të territoreve mes Kosovës dhe Serbisë. Në një bisedë për “Kohën Ditore”, diplomati austriak ka thënë se Kosova tashmë ka bërë kompromiset e saj, duke pranuar Pakon e Marti Ahtisaarit, mbi bazën e së cilës Kosova shpalli pavarësinë më 17 shkurt të vitit 2008. “Me pranimin e të drejtave të gjera për minoritetet, në veçanti për komunitetin serb dhe Kishën Ortodokse Serbe, siç përfshihet në Planin e Ahtisaarit, si



dhe decentralizimin e kompetencave administrative, Kosova tashmë ka bërë kompromiset e saj”, ka thënë ish-zëvendësi i Ahtisaarit. Por, sipas tij, reciprociteti ka munguar nga ana e Serbisë, për të cilën thotë se vazhdon të ketë qëndrim armiqësor ndaj Kosovës.

Mediat serbe: KFOR-i amerikan ushtron FSK-në për t'u bërë Ushtri



Pjesëtarë të KFOR-it amerikan tash e disa ditë në malet e Bajgorës po ushtrjnë pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës për Ushtrinë e ardhshme të Kosovës, shkruan gazeta e Beogradit “Večernje Novosti”. Kjo gazetë, duke futur në thonjëza Ushtrinë e Kosovës dhe duke e quajtur Kosovën “shtet të rremë”, tregon se burime të saj kanë pohuar se ushtrimet po bëhen me më së paku nga 100 pjesëtarë të FSK-së, të cilët në periudha të ndryshme kohore ndërrohen me të tjerë në Bajgorë. Pos që i ushtrjnë pjesë-

tarët e FSK-së, KFOR-i amerikan edhe po i armatos me të madhe këta ushtarë. “Komanda e FSK-së ka blerë nga amerikanët 27 automejta luftime Hummer ndërsa 24 sish i ka marrë dhuratë”, citon gazeta gjoja burimin e vet, transmeton Koha.net. Gazeta shton se shqiptarët e Kosovës me nxitim po i intensifikojnë ushtrimet me amerikanët në kuadër të operacionit të përbashkët “Shpata e artë”, të cilat ky medium serb i quan fazë finale e marrjes së veriut dhe rrumbullakim të sovranitetit të Kosovës.



“Prekja e kufijve të Kosovës do të çonte në një luftë”. Ish-ministria, përgjegjëse për Dialog e Republikës së Kosovës, Edita Tahiri, thotë se Kosova është e vendosur të mbrojë integritetin territorial të saj. Në një intervistë për mediat Tahiri u përgjigjet disa pyetjeve në lidhje me fazën finale të dialogut me Serbinë, ku ka deklaruar se

PREKJA E KUFIJVE MUND TË SJELLË LUFTË!

prekja e kufijve të Kosovës, çon në luftë. Tahiri është shprehur se Kosova dhe aleatët e saj nuk mund të bien pre e politikave dhe provokimeve të Serbisë dhe Rusisë, por duhet të jetë e vendosur të ndjekë rrugën e saj për njohje reciproke mes dy shteteve sipas agjendave euroatlantike. “Sa më shumë që afrohem tek finalja e dialogut, Serbia del me skenare të rrezikshme dhe këto janë pikërisht skenarë të mundësisë së ndarjes së Kosovës apo të shkëmbimit të territoreve dhe këto të gjitha kanë të

bëjnë me ambicie të Serbisë, e cila dhe sot synon krijimin e Serbisë së Madhe në dëm të shteteve të tjera, në këtë rast në dëm të Kosovës dhe kombit shqiptar dhe janë të nxitura po ashtu edhe nga agjendat gjeopolitike ruse, – tha ajo për Televizionin Publik Shqiptar. – Pavarësisht skenarëve të rrezikshme të Serbisë, Kosova është e vendosur dhe në dialog do të mbrojë sovranitetin, integritetin territorial dhe çfarëdo marrëveshje finale që mund të dali nga dialogu i Brukselit duhet të jetë dhe do të jetë në

pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës”, thekson Tahiri. Tahiri shton se ky është një skenar i rrezikshëm i Serbisë për destabilizimin e të gjithë rajonit, i cili duhet ndaluar sa më parë. “Këto janë të nxitura nga Serbia, por unë jam e bindur që janë po ashtu të mbështetura nga Rusia e cila ka një rikthim të ambicieve gjeopolitike ndaj Ballkanit. Por një mesazh që duhet ti dërgohet faktorit ndërkombëtar është se prekja e kufijve të Kosovës, çon në luftë, sepse Ballkani është i njohur që nuk

bën prekje kufijsh apo ndryshim kufijsh në forma të tjera dhe e dyta që në rastin e Kosovës nuk mund të flasim vetëm për shtetin e Kosovës, por duhet të shikojmë edhe kombin shqiptar, nëse preken kufijtë në Ballkan, duhet të preken për të gjithë Ballkanin dhe me këtë rast edhe të gjithë shqiptarët do të ishin të hapur për të biseduar, por prekja parcale e kufijve do të krijonte një efekt domino me efekte destabilizuese deri në mundësinë e ndonjë lufte të re mes Kosovës dhe Serbisë”.

Gjermani, çdo i katërti me origjinë të huaj

Numri i individëve me prejardhje të huaj në Gjermani ka arritur një rekord të ri në vitin 2017. Siç bëri të ditur, Zyra Federale e Statistikave në Republikën Federale të Gjermanisë jetonin vitin e kaluar 19,3 milionë gra, burra e fëmijë që kanë sfond migrimi. Kjo përbën 4,4% më shumë se një vit më parë. Pjesa e përgjithshme e të huajve në numrin e popullsisë gjermane përbën 23,6%. Në Gjermani një person quhet me sfond migracioni, kur ai vetë, ose njëri nga prindërit nuk ka lindur me shtetësi gjermane. Rreth 51% e popullsisë me sfond migrimi janë gjermanë, 49% kanë një pasaportë të huaj. Ndër 19,3 milionë individë me origjinë të huaj në Gjermani, 2,8 milionë kanë prejardhje turke, 2,1 milionë janë me origjinë polake, 1,4 milionë me origjinë ruse, 1,2 milionë me origjinë kazake dhe 0,9 milionë me prejardhje rumune. Të dhënat bazohen në mikrocensusin, regjistrimin sporadik ku çdo vit pyetet 1% e popullsisë në Gjermani. Statusi i migrimit u pyet tek personat banues privatë dhe jo në qendra komuniteti.

ÇFARË E LIDH TURQINË ME EVROPËN?

Po të vijë në vjeshtë për vizitë në Gjermani Presidenti turk Recep Tayyip Erdogan, do të ketë shumë probleme për të diskutuar me mikpritësit. Sfidat vërtet të mëdha mund të zgjidhen vetëm me përpjekje ndërkombëtare

Rreth katër milionë njerëz nga Siria ka pranuar Turqia aktualisht; marrëveshja e BE me Turqinë luan në këtë kuadër një rol të madh. Që prej shkurtit 2016 sirianëve u lejohet të punojnë në Turqi. Kjo ka bërë që shumë prej punëve të thjeshta, me paga të ulëta që kryeshin më parë nga vendasit, tani bëhen nga sirianët. Refugjatët bënë edhe që qirat të rriten, para së gjithash në lindje të Turqisë. Nga ana tjetër, refugjatët sirianë në bazë të të dhënave zyrtare kanë investuar tashmë mbi 330 milionë dollarë në ekonominë turke - për shembull për të ngritur sipërmarrjet e tyre. 6000 të tilla ekzistojnë tashmë.

Megjithatë refugjatët nuk kanë mundur ta bëjnë deri tani për vete Turqinë. "A është vendi ynë kuzhinë popullore? Vendi im është plot të papunë", tha në fushatën elektorale për zgjedhjet presidenciale në Turqi sfiduesi i Erdoganit, Muharrem Ince nga Partia Popullore Republikane (CHP). Kundër Erdoganit ai nuk pati shans, por arriti në vendin e dytë me 30 për qind të votave, edhe në sajë të kritikës për politikën e refugjatëve të Erdoganit. Shprehje kritike të tilla dëgjohen me dëshirë nga një pjesë e popullit, në një kohë kur ekonomia turke po tregon shenja dobësie në shumë aspekte.

ERDOGANI NËN PRESION

Në përputhje me këtë Erdoganit është nën presion edhe pas zgjedhjeve. Prandaj ai përpiqet që me ndihmën e ushtrisë dhe të milicëve sirianë të paguar t'i vendosë

nën kontrollin e tij pjesë të Sirisë Veriore, thotë Günter Meyer, Drejtues i Qendrës për Studimin e Botës Arabe në Universitetin e Mainzit. "Kjo do të ishte një zonë që në këndvështrimin e Erdoganit është e përshtatshme për të lehtësuar kthimin e sirianëve nga Turqia".

Për Evropën, për Gjermaninë, interesi i Erdoganit ofron shanse dhe vështirësi njëkohësisht. Kështu me sa duket Erdoganit është mirënjohës për çdo refugjat sirian, që largohet sërish nga Turqia - pavarësisht se në cilin drejtim. Në këtë kuadër, numri i refugjatëve që mbërrijnë nga Turqia në Greqi që prej fillimit të majit është nëntëfishuar, më shumë se 15.000 vetë e kaluan Mesdheun midis Turqisë dhe Greqisë. Prandaj Komisari i BE për Migrimin dhe Punët e Brendshme, Dimitris Avramopoulos, kërkoi që të rritet prania e rojës kufitare dhe bregdetare prej 1500 vetash të BE. Njëkohësisht ai tha se marrëveshja për refugjatët midis BE dhe Turqisë vazhdon të funksionojë.

TURQISË I DUHET STABILITET NË SIRI

BE dhe njëkohësisht Gjermania përfitojnë nga interesi i Erdoganit për të kontribuar sa më shumë që të jetë e mundur për paqëtimin e shtetit fqinjë. "Turqia është shumë e varur nga stabiliteti në shtetin fqinj", thotë Günter Meyer. Ky është edhe interesi i Gjermanisë - një pikë tjetër lidhëse, po ta vizitojë Erdoganit në vjeshtë Gjermaninë. Turqia ka ftuar në fillim të shtatorit

edhe për t'u konsultuar për zhvillimet në Siri në një bisedë katërshe Rusinë, Francën dhe Gjermaninë. Vërtet që ende nuk ka reagime nga këto vende, por të gjithë janë të interesuar për fundin e luftës në Siri dhe për kthimin e refugjatëve në atdheun e tyre.

SHENJA AFRIMI NGA GJERMANIA

Edhe Gjermania sinjalizon vullnet për një afrim të ri. Kështu një pjesë të sanksioneve ndaj Turqisë qeveria gjermane nuk i zgjati. Sipas mediave, kufiri i sipërm i garantimit të eksporteve në Turqi nga qeveria gjermane, i vendosur më 2017 si mjet presioni ndaj Turqisë, këtë vit nuk u zgjat - dhe kjo pavarësisht faktit se situata e të drejtave të njeriut në Turqi nuk është përmirësuar dhe në burgjet e Turqisë ndodhen edhe më tej 46 nënshtetas gjermanë. Ministria e Jashtme i zbuti pas fundit të gjendjes së jashtëzakonshme në Turqi edhe këshillat për udhëtimin për turistët dhe biznesmenët. Nga kjo përfiton veçanërisht industria turke e turizmit. Ajo e ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme një zbutje të tillë. Jo vetëm Gjermania, edhe Holanda kërkon që pas fundit të gjendjes së jashtëzakonshme t'i vërë marrëdhëniet me Turqinë në baza më të mira. "Një normalizim i plotë i marrëdhënieve turko-evropiane megjithatë nuk është i afërt, sepse vazhdojnë të ekzistojnë shumë dallime politike edhe pas heqjes së gjendjes së jashtëzakonshme", thotë Günter Seifert nga "Fondacioni Shkenca dhe Politika". (DW)



Të paktën 91 të vdekur pas tërmetit në Indonezi

Të paktën 91 persona kanë vdekur pas një tërmeti të fuqishëm që ka goditur ishullin indonezian, Lombok. Qindra persona janë plagosur si pasojë e tërmetit të së dielës, derisa zyrtarët kanë thënë se shumica e viktimave gjenden ne veri të ishullit. Tërmeti i shkallës shtatë ka ndodhur në vetëm 10 kilometra thellësi nëntokësore, duke dëmtuar mijëra ndërtesa dhe duke ndërprerë energjinë elektrike. Në ishullin e afërt, Bali, janë publikuar pamje teksa njerëzit kanë ikur duke bërë turr nga shtëpitë e tyre. Në ditën e diel po ashtu është paralajmëruar për një cunami, mirëpo njoftimi është tërhequr më vonë. Ky tërmet vjen një javë pasi një tjetër goditje ka prekur ishullin Lombok, i cili vizitohet nga shumë turistë për shkak të plazheve që ka. Tërmeti i mëparshëm ka lënë të vdekur të paktën 16 persona.

Djali i Bin Ladenit martohet me vajzën e "trurit" të 11 shtatorit

Hamza bin Laden, një nga djemtë e ish-liderit të Al Kaedës, është martuar me vajzën e Mohammed Atta, "truri" i sulmeve të 11 shtatorit në SHBA. Lajmi bëhet i ditur nga vëllezërit nga babai të të riut, sipas asaj që zbulon gazeta britanike "The Guardian", e cila pak ditë më parë ka intervistuar edhe nënën e Osa-

mas. Sipas Ahmad e Hassan al-Attas, Hamza ka pasur një rol prej lideri në brendësi të organizatës terroriste dhe ka si qëllim për t'u hakmarrë për babain e tij, i vrarë në një sulm ushtarak amerikan në Pakistan shtatë vjet më parë. Emri i nuses nuk është zbuluar, por besohet të jetë shtetase egjiptian në në fund të adole-

shencës ose në fillim të 20-ave. Hamza thuhet të jetë numri dy në organizatën al-Kaida, ndërkohë që lideri aktual është Ayman al-Zawahiri.

Hamza është djali i Osamas dhe i Khairiah Sabar, një nga tre gratë e ish-kryeterroristit islamik, i cili jetonte me të në zonën e Abbottabad. "Nuk e dimë ku

ndodhet, por besojmë se është në Afganistan", - kanë zbuluar për "The Guardian" vëllezërit e tij nga babai.

Në dy vitet e fundit, shërbimet sekrete perëndimore kanë intensifikuar ndjekjen ndaj Hamza-it, i konsideruar një figurë e rëndësishme për ithtarët e Al Kaedës.



Në bazë të nenit 35 paragrafi (3) të Ligjit për Planifikim Urbanistik dhe Hapësinor, (G. Zyrtare e RM-së nr. 199/14, 44/15, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16) dhe Vendim me nr. 10-175/4 dt. 27.07.2018 Kryetari i Komunës së Tetovës, e lëshon këtë:

KOMUNIKATË

për organizimin e Përsëritur të Prezantimit Publik dhe Anketës publike të Propozim Planit Detal Urbanistik për BU 8, KK Tetovë 1

Njoftohen qytetarët dhe personat juridik të komunës së Tetovës, se Kryetari i komunës së Tetovës mori Vendim për organizimin e Përsëritur të Prezantimit Publik dhe Anketës publike të Propozim Planit Detal Urbanistik për BU 8, KK Tetovë 1, komuna e Tetovës me nr. teknik 1-1/17 i përpunuar nga "URBANPLAN"-SHPK Tetovë, Periudha planore 2017-2022.

Kufiri i përfshirjes planore definohet përmes rr. "Ivo Ribar Lola", rr. "Bllagoja Toska", rr. „Bllagoja Toska - krah„.

Përfshirja është me sipërfaqe prej 7.25 ha.

Brenda përfshirjes planore të Planit Detal Urbanistik për BU 8, KK Tetovë 8, planifikohen këto klasa themelore të destinimit si në vijim: A1 - banim në shtëpi banesore, B1-Komerciale të vogla dhe objekte afariste, D3 – Sport dhe rekreacion, E2 - Suprastrukturë komunale, E1 - Infrastrukturë komunale.

ANKETA PUBLIKEE PËRSËRITUR të Propozim Planit Detal Urbanistik për BU 8, KK Tetovë 1, komuna e Tetovës, do të zgjas 5 ditë pune, kurse do të mbahet në periudhën nga 13.08.2018 – 17.08.2018 vjet.

Komunikata për prezantimin publik dhe anketën publike është e publikuar në (2) medime publike, në veb faqen e komunës www.tetovo.gov.mk dhe në sistemin e e-urbanizmit.

PREZANTIMI PUBLIK I PËRSËRITUR të Propozim Planit Detal Urbanistik për BU 8, KK Tetovë 1, në komunën e Tetovës, do të mbahet me dt. 14.08.2018 në ora 11:00, në zyrën nr.20 në Komunë - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Fletat anketuese për pjesëmarrje në anketën publike, qytetarët e interesuar mund t'i marrin në hapësirat e Komunës - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në zyrën nr.20 ose në formën elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

Në afatin e caktuar qytetarët e interesuar dhe personat juridik nga territori konkret i përfshirë në planin, mund të dorëzojnë vërejtje me shkrim, propozimet dhe mendimet në fletat anketuese nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm ose në mënyrë të shkruar.

Shtojca grafike e Planit Detal Urbanistik për BU 8, KK Tetovë 1, do të ekspozohet në tabelën e shpalljes në ndërtesën e komunës së Tetovës dhe në veb faqen e komunës www.tetovo.gov.mk, informata më detale për Planin detal urbanistik do të mund të merren në Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Kryetar,
Teuta Arifi

Në bazë të nenit 35paragrafi (3) të Ligjit për Planifikim Urbanistik dhe Hapësinor, (G. Zyrtare e RM-së nr. 199/14, 44/15, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16) dhe Vendim me nr. 10-7851/2 dt. 27.07.2018Kryetari i Komunës së Tetovës, e lëshon këtë:

KOMUNIKATË

për organizimin e Prezantimit Publik dhe Anketës publike të Propozim Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 79

Njoftohen qytetarët dhe personat juridik të komunës së Tetovës, se Kryetari i komunës së Tetovës mori Vendim për organizimin e Prezantimit Publik dhe Anketës publike të Propozim Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 79, KK Tetovë, komunën e Tetovës me nr. teknik 11/2017i përpunuar nga "IN-PUMA" Institut për urbanizëm, komunikacion dhe ekologji Shkup. Periudha planore 2017-2022.

Kufiri i përfshirjes planore definohet përmes rr. "VII. Miladinov", rr. "Vidoë Smilevski Bato", rr. „Jashtë Vardarit. Përfshirja është me sipërfaqe prej 172450 m².

Brenda përfshirjes planore të Propozim Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 79, KK Tetovë, planifikohen këto klasa themelore të destinimit si në vijim:

A - Banim

A1 - Banim në shtëpi banimi

V - Institucionet publike

V2 – Mbrojtje shëndetësore dhe sociale (Kopsht për fëmijë)

D - Prodhim, shpërndarje dhe shërbime

G2 - Industri e lehtë dhe jo ndotëse

G3 - Servis

G4 - Depo

D - Gjellbërim dhe rekreacion

D2 – Gjellbërim mbrojtës

E - Infrastruktura

E1-Infrastruktura komunale

E2 -Infrastruktura komunale (Pompë për benzinë)

E2 - Suprastrukturë komunale (Trafostacionet)

ANKETA PUBLIKE sipas Propozim Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 79, KK Tetovë, komunën e Tetovës, do të zgjas 10 ditë pune, kurse do të mbahet në periudhën nga 13.08.2018 – 24.08.2018 vjet. Komunikata për prezantimin publik dhe anketën publike është e publikuar në (2) medime publike, në veb faqen e komunës www.tetovo.gov.mk dhe në sistemin e e-urbanizmit.

PREZANTIMI PUBLIKsipas Propozim Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 79, KK Tetovë, në komunën e Tetovës, do të mbahet me dt. 15.08.2018 në ora 11:00, në zyrën nr.20 në Komunë - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Fletat anketuese për pjesëmarrje në anketën publike, qytetarët e interesuar mund t'i marrin në hapësirat e Komunës - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në zyrën nr.20 ose në formën elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

Në afatin e caktuar qytetarët e interesuar dhe personat juridik nga territori konkret i përfshirë në planin, mund të dorëzojnë vërejtje me shkrim, propozimet dhe mendimet në fletat anketuesenëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm ose në mënyrë të shkruar.

Shtojca grafike e Propozim të Propozim Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 79, KK Tetovë, do të ekspozohet në tabelën e shpalljes në ndërtesën e komunës së Tetovës dhe në veb faqen e komunëswww.tetovo.gov.mk, informata më detale për Planin detal urbanistik do të mund të merren në Sektorin e urbanizmitdhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Kryetar,
Teuta Arifi

Koha
E përditshme informative

ÇMIMORE PËR PREZANTIM TË PAGUAR PËR REFERENDUM

Faqja e parë (color) 1 cm ²	2,5 €
Faqja e fundit (color) 1 cm ²	1,04 €
Faqja e brendshme (color) 1 cm ²	1,00 €
Faqja e brendshme (bardhë e zi) 1 cm ²	0,70 €
1/1 faqja e brendshme (bardhë e zi)	450 €
1/2 faqja e brendshme (bardhë e zi)	252 €
1/4 faqja e brendshme (bardhë e zi)	162 €
1/1 faqja e brendshme (color)	585 €
1/2 faqja e brendshme (color)	342 €
1/4 faqja e brendshme (color)	180 €
1/2 faqja e brendshme portret (bardhë e zi)	360 €
1/2 faqja e brendshme portret (color)	450 €

Shërbime speciale: - kërkesa e veçantë për pozicionim të reklamës e rrit çmimin për 25%.

Në çmim nuk është llogaritur TVSH-ja.

Dimensionet

1/1250 x 385 mm

1/2250 x 190 mm

1/4122 x 190 mm



ZENDELI, SHKUPJANI QË SYNON FORMULA 1



Sot e pëlqen por paralel ëndërron dhe punon për të qenë një ditë pjesë e nivelit më të lartë të garave me makina të shpejta. Lirim Zendeli duket i determinuar për të ecur përpara, ndërsa me shpresën se nuk do të mungojë mbështetja financiare, shkupjani premton të japë më të mirën për tu bërë shqiptari i parë që do të garojë në Formula 1

Shkup, 6 gusht - Lirim Zendeli nga Shkupi, por që jeton në Gjermani, garon në kategorinë e Formula 4. Se në të vërtetë bëhet fjalë për një talent të madh të këtij sporti dhe jo vetëm për fjalë dëshmon performanca e tij në këtë sezon të Formula 4, ku shkupjani u shpall kampion i këtij kampionati, duke lënë pas vetes ndjekësit e tij me diferencë shumë të madhe të pikëve. I pasionuar pas makinave të shpejtësive që në moshë shumë të re, Zendeli në një intervistë për televizionin "Shenja" ka zbuluar star-

tin e tij në botën e këtij sporti. "Po në fillim, unë kam qenë i pasionuar pas veturave të shpejta, babi im gjithmonë i ka ndjekur Formulën dhe kështu më pas shkonim në karting dhe hap pas hapi erdhim puna që të garojë në Formula 4", shprehet në fillim Zendeli. Nga kartingu fillestar deri te Formula 4 ku shfaq dominim për momentin, në kushte kur talenti i padiskutueshëm dëshmohej thujtë pas çdo gare, ngritja e të riut nga Shkupi në nivelet më të larta tashmë varet direkt nga mbështetja finan-

ciare. "Shpresojmë që mundem të arrijë të garojë edhe në Formula 3, por varet shumë nga financimi. Talentin besoj që e kam dhe jam mjaftë i aftë për të arritur në Formula 3, mirëpo na nevojiten sponsor, pasi deri më tash babai im me një sponsor nga Bohum janë duke na sponsoruar në Formula 4, ndërsa për t'u kyçur në Formula 3 nevojiten edhe më shumë financa", shtoi më tej i riu nga Shkupi, i cili synon të kalojë nivelet një nga një për të prekur majat e këtij sporti, duket shumë i motivuar për të

Mihael Shumaherin e kam njohur që nga moshë e vogël, pasi në karting kemi qenë pjesë e ekipit të tij, ku edhe djali i tij garonte së bashku me ne. Këtë vit na kanë mundësuar që të kemi takim me Sebastian Fetelin, kemi qenë në boksën e Ferrarit, ku jemi shoqëruar së bashku me ekipin e Ferrarit, na kanë treguar të gjitha gjërat se si punojnë, që ishte diçka shumë interesante. Unë e kam qejf shumë Luis Hamiltonin, se është një pilot pak më egoist se tjerët, pak më agresiv dhe shumë më pëlqen se si garon në Formula



Sadiku do të mungojë 6 muaj!

Armando Sadiku e mbyll 2018-ën edhe pa nisur sezonin. Sulmuesi i Levantes, do të mungojë për 6 muajt e ardhshëm pasi ka këputur ligamentin kryqëzor të gjurit të majtë e për rrjedhojë duhet t'i nënshtrohet ndërhyrjes kirurgjikale. Ishin ekzaminimet e thelluara të kësaj të hënë që vërtetuan atë që i frikësohej më shumë futbollistit i Kombëtares Shqiptare. 26-vjeçari u dëmtua në miqësoren me Heerenvenin të shtunën e kaluar. Mungesa e tij gjatë gjashtë muajve të ardhshëm do të ndihet shumë edhe në përfaqësuesen kuqezi në ndeshjen e "Nations League" që nisin në shtator. Një moment vërtetë negativ ky për futbollistin kuqezi, që prej transferimit te klubi i La Ligas në janar të vitit 2018 ka pasur probleme të njëpasnjëshme. Ambien-timi në elitën e futbollit spanjoll u vështirësua nga mungesat e vazhdueshme në fushë për shkak të problemeve fizike, që nuk e lejuan thujtë për asnjë moment të ishte në formë optimale. Gjatë kësaj vere, klubi i Levantes e kishte përfshirë Sadikun në listën e lojtarëve që mund të shiteshin, ndërsa gjatë fazës përgatitore "bomberi" shqiptar po bënte të pamundurën që të bindte drejtuesit dhe stafin teknik, për të fituar vendin e tij në skuadër. Një mision që u realizua përgjysmë. Kjo edhe për faktin se me dëmtimin e pësuar në gju dhe ndërhyrjen kirurgjikale, Armando Sadiku do të qëndrojë me ekipin nga Valencia për të vijuar fazën e rehabilitimit të plot. Një mënyrë për t'u rikthyer më i fortë dhe për të provuar ndoshta të jetë protagonist me Levanten në gjysmën e dytë të sezonit në kampionatin spanjoll.

dhënë më të mirën në drejtim të ngritjes së nivelit me më të mirët e garave me makina të shpejta, duke shpresuar se në të njëjtën kohë do të arrijë edhe mbështetja e nevojshme nga sponsorët. "Është vështirë për ta thënë, pasi edhe ajo varet nga financimet. Ka prej tyre që garojnë vetëm një në Formula 3 dhe kualifikohet në Formula 2, por ka edhe prej tyre që garojnë nga dy vite në Formula 3 dhe dy vite tjera në Formula 2. Nuk dihet se në çfarë rrugë je, por mund të jesh në Formula 1 pas katër viteve, por mund edhe pas 5 ose 6 viteve", përfundoi Zendeli.

NË RAST SE ELIMINON SALLZBURGUN

SHKËNDIJA NË PLEJ-OF KUNDËR SERBËVE OSE ÇEKËVE

Shkup, 6 gusht - Skuadra e Shkëndijës të hënën ka mësuar kundërshtarin me të cilin do të përballlet në fazën 'play off' të Ligës së kampionëve, sigurisht nëse do të arrijë të bëjë mrekullinë ndaj Sallzburgut në raundit të tretë kualifikues. Shorti i ka rezervuar si kundërshtari të mundshëm ekipit tetovar fituesin e çiftit Cërvena Zvezda-Spartak Tërnavë.

Ndeshjet e fazës 'play off' janë programuar për t'u zhvilluar me 21/22 gusht dhe 28/9 gusht. Nëse Shkëndija do të eliminohej nga Sallzburgu, atëherë në fazën 'play off' të "Europa League" do të për-



ballet me fituesin e çiftit Kork Siti - Rozenborg. Ndërkohë, Dinamo Zagrebi pjesë e së cilës është futbollisti shqiptar Arijan Ademi, në

rast se eliminojnë Astanan për kundërshtar do të kenë Jang Bojsin. Fenerbahçe e Elif Elmas në rast se arrijnë të triumfojnë në dy

përballjet me Benfikën, plasmin në grupe do ta kërkojnë nëpërmjet fituesit PAOK-Spartak Moskë.

MUNIH 1860, KUR EDHE FERRI TË DUKET PARAJSË!

Në vitin 2010, pronari Ismaik, jordanez, premtoi ndryshimin dhe investimet, por ishte thjesht një "mashtues" i radhës, i paskrupullt, që u fut në luftë me DFB dhe la mes katër rrugëve Munih 1860. Ismaik u largua me valixhen e tij duke mos paguar as regjistrimin në ligën e tretë, teksa rënia në kategorinë e katërt dhe jo profesionistët ishte një grusht i rëndë për këdo



Një mit që bie dhe që provon të ringrihet. Një rugëtim i cili i vetëm kurrësi nuk mund të bëhet, sidomos nëse e nis nga së largu, aty ku ndoshta thjesht mendimi se elita qëndron dy kategori më lart të fut frikën dhe të dekurajon. Por, kur je në mes të popullit, kur populli yt, i përkthyer në tifozeri, është aty për të të dhënë zemër, atëherë asgjë nuk është e pamundur. Munih 1860, një klub i lavdishëm në Gjermani, një ndër më të vjetrit, duke qenë se u themelua pikërisht 158 vjet më parë, mbahet mend dhe se është bashkëthemeluesi i të famshmes Bundesligë, edhe pse për pjesën më të madhe të viteve '80 ka luajtur në divizionin e tretë. Financat kanë qenë "thembra e Akilit". Ajo thembër që megjithatë është kaluar në disa

momente dhe ka barë Munihun bardhekaltër që të festojë tre herë: një titull dhe dy Kupa të Gjermanisë, por edhe finalja e famshme e Kupës së Kupave 1964-1965. Të tjera kohë, të arta, sepse tani po përjetohet ferri. Një administrim totalisht i gabuar i klubit dhe financave solli rënie në kategorinë e katërt, pra te Rajonal Liga. Një kryqëzim që nisi që në vitin 2000, edhe pse Bajerni provoi ta shpëtonte dhe t'i jep-te oksigjen, duke i blerë kuotat më të mëdha të stadiumit "Allianz" dhe lënë më pas me qira. Në vitin 2010, pronari Ismaik, jordanez, premtoi ndryshimin dhe investimet, por ishte thjesht një "mashtues" i radhës, i paskrupullt, që u fut në luftë me DFB dhe la mes katër rrugëve Munih 1860.

Ismaik u largua me valixhen e tij duke mos paguar as regjistrimin në ligën e tretë, teksa rënia në kategorinë e katërt dhe jo profesionistët ishte një grusht i rëndë për këdo. Jo për Munih 1860, që provon të ringrihet dhe pasi arriti të ngjitej sërish në divizionin e tretë, aty ku sot luajti ndaj Lote dhe fitoi 5-1. Stadiumi i vjetër i klubit, "Städtisches Stadion an der Grünälder Straße", me vetëm 12.500 vende, ishte i mbushur përplot. Tifozët dhuruan një dekor fantastik, nga më të mëdhenjtë, te më të vegjlit. Sepse, miti nuk vdes kurrë. Ndoshta, e mbulon pluhuri, ndoshta lihet pak në harresë, por një ditë kthehet dhe kthehet bashkë me ata që nuk ka humbur asnjë sekondë të jetës, tifozerinë, popullin e saj.

RAIOLA UDHËTON NË MANÇESTER

Ndërmjetëson kalimin e Pogbas te Barcelona

Super-agjenti Mino Raiola pritet të atërojë në qytetin e Mançesterit këtë javë për të diskutuar të ardhmen e klientin të tij, Pol Pogba.

Sipas mediumit anglez "The Mirror", e ardhmja e Pogbas do të zgjidhet në ditët në vazhdim kur agjenti i tij Raiola të fluturojë në Angli. Raiola do të mbajë bisedime me hierarkinë e "Djajve të Kuq" rreth një largimi të mesfushorit francez. Mediumi anglez raporton se Raiola mund të

ndërmjetësojë një lëvizje prej 100 milionë funtesh apo 113 milionë eurosh në Barcelonë. Pogba ka luftuar për të prodhuar më të mirën për nën drejtimin e Hoze Murinjos në "Old Trafford", të cilën nuk ka arritur dhe ishte larg nga paraqitjet e tij të mira në Kupën e Botës këtë verë. 25-vjeçari ishte vendimtar për suksesin e vendit të tij në Rusi, ku u shpallën kampion bote pasi mposhtën Kroacinë në finale. Murinjo është dukshëm i zhgënjyer me mungesën

e investimit të klubit të tij në afatin kalimtar të transferimeve këtë verë dhe do të ngurrojë të lërë Pogba të largohet pa një zëvendësim. Megjithatë, mediat raportojnë se Pogba tashmë ka pranuar kalimin në "Camp Nou" dhe ka zgjedhur numrin 8, i cili ka mbetur i lirë pas largimit të legjendës Andres Iniesta.

SportFlash

Zbulohet propozimi i

Jiangsu për Modriçin

Edhe pse Perez e Lopetegui e kanë bërë të qartë se nuk heqin dorë nga Luka Modriç, tek Interi vazhdojnë të këmbëngulin për shërbimet e mesfushorit kroat. Jo vetëm kaq, por në Itali po planifikojnë edhe se si do e bindin futbollistin e Real Madridit të transferohet në Serie A. Duke qenë se Modriç ende nuk i është bashkuar spanjollëve në stërvitje, kanë nisur të qarkullojnë shumë zëra mbi të ardhmen e mesfushorit, i cili shkëlqeu në "Rusi 2018" me Kroacinë e tij që shkoi deri në finale dhe u mund nga Franca. Për të bindur Modriçin ka ndërhyrë grupi "Sunning", që i ofron mesfushorit që për katër vite të nënshkruajë me Interin, ndërsa më pas do të transferohet te Jiangsu. Miliona për të në moshën 36-vjeçare dhe mbyllje kariere në Kinë.

Duel në Angli për shërbimet e Boateng

PSZH ishte klubi i parë që nisi "sulmin" për të afruar në ekip Zherom Boateng, madje edhe vetë drejtuesit e klubit gjerman konfirmuar bisedimet për transferimin e qendërmbrojtësit të kombëtares. Por për të nuk ka interes vetëm PSZH. Mançester Junajtedi gjithashtu po kërkon për një lojtar që t'i garantojë në qendër të prapavijës. Boateng është në listën e dëshirave të Murinjos. Gjithsesi në Angli tashmë është futur në garë edhe një tjetër ekip sikurse raporton "Kicker". Arsenali do një tjetër mbrojtës në ekip dhe Emeri i ka kërkuar klubit që të tentojnë Boateng. Junajted shihet në "pole" për lojtarin e Bajernit të Munihut, madje kanë kontaktuar edhe me kampionët e Gjermanisë. Për shërbimet e Boateng çdo klub që e do duhet të paguajë rreth 45 milionë sterlina.

Tri skuadra angleze pas

Zhao Marios

Zhao Mario aktualisht është duke u stërvitur me Interin, por jo për gjatë. Për portugezin kanë shfaqur interesim shumë skuadra nga Liga Premier. Pas Uest Hemit tek të cilët ishte i huazuar në sezonin e fundit 2017/18, për portugezin kanë shfaqur interesim tani edhe Leicester Siti e Vulverhemptoni. Sipas "Gazzetta dello Sport", edhe vet lojtari ka shfaqur interesim për t'u kthyer në Angli.

Publicitet



Në bazë të nenit 31 alinea 6 e Ligjit për veprimtari hulumtuuese-shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 46/08, 103/08, 24/11, 80/12, 24/13, 147/13 dhe 41/14 145/15 dhe 154/15), dhe nenit 16 të Statutit të Institutit, Këshilli i IPSH Institutit për Trashëgimi Kulturor dhe Shpirtëror të Shqiptarëve – Shkup sjellë Vendim nr. 0201-287/2 të datës 31.07.2018 me të cilin shpallë:

Konkurs publik

Për zgjedhje të drejtorit të IPSH Institutit për Trashëgimi Kulturor dhe Shpirtëror të Shqiptarëve – Shkup
1. Publikohet Konkurs publik për zgjedhje të drejtorit të IPSH Institutit për Trashëgimi Kulturor dhe Shpirtëror të Shqiptarëve – Shkup.

Kandidati duhet të përmbushë kushtet në vijim:

- të ketë titull mësitor shkencor doktor i shkencave nga sferat në të cilën kryen veprimtarinë Institutit;
- përvojë pune prej 5 vjet në institucion mësitor shkencor nga sfera në të cilën kryen veprimtarinë Institutit;
- të jetë punëtor i afirmuar;
- të posedojë aftësi për organizim të punës në institut;
- të parashtrijë propozim program për punë dhe zhvillim;
- të jetë shtetas i R. Maqedonisë;

Krahas fletëparaqitjes kandidati duhet të parashtrijë dokumentet në vijim:

- biografi
 - certifikatë për titullin e arritur shkencor doktor i shkencave
 - listë dhe kopje të punimeve të publikuara shkencore
 - certifikatë të shtetësisë
 - certifikatë të lindjes
2. Dokumentet e parashtruara duhet të jenë në original ose kopje të vërtetuara në noter.
3. Konkursi do të zgjasë tetë (8) ditë pune nga dita e publikimit të konkursit.
4. Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrihen drejtpërdrejtë në Institutin për trashëgimi kulturor dhe shpirtëror të shqiptarëve (ish Ambasada amerikane në rr. Ilindenska pn), ose përmes postës në adresën: fahu postal 171, 1000 Shkup.
5. Fletëparaqitjet të cilat nuk do të parashtrihen brenda afatit të caktuar dhe fletëparaqitjet të cilat nuk përmbajnë dokumentet e kërkuara do të konsiderohen si të vonuara dhe të pakompletuara dhe të njëjtat nuk do të merren parasysh.

Këshilli i IPSH Institutit për Trashëgimi Kulturor dhe Shpirtëror të Shqiptarëve – Shkup

DASHI 21. mars - 20. prill
Dita e sotme do jete shume e paqëndrueshme për ata qe janë ne një lidhje. Debatet me partnerin do jene te zjarra ne orët e para te ditës dhe kjo diu merrzitet jashtë mase. Beqaret do tregohen me te hapur për takime dhe do kenë një dite plot te reja. Ne planin financiar nuk priten vështirësi te mëdha nëse tregoheni te matur me shpenzimet qe do kryeni.

DEMI 21. prill - 21. maj
Për sa iu përket çështjeve te zemrës, dita e sotme do jete e mrekullueshme. Do komunikoni gjate gjithë kohës me partnerin tuaj te dashur dhe do zgjidhni çdo keqkuptim pa arritur ne debate te zjarra. Beqaret do lëvizin çdo gur për ta gjetur personi e duhur dhe do ia arrijnë qëllimit. Nëse harxhoni një pafundësi te ardhurash vetëm për t'ia bere qejfin vetes, situata financiare do ketë probleme.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
Nëse tregoheni shume te drejtpërdrejtë sot me partnerin tuaj, si mund edhe te mos e vlerësojë këtë apo mund t'i ngelet hatri. Kujdes me çdo gjë qe do thoni. Beqaret do kenë takime pa fund dhe do e gjejnë personin qe aq shume e kane ëndërruar. Pluioni do jene i pafavorshëm për shtatorin e financave, prandaj mos hidhni hapa te nxituara qe te mos keni vështirësi.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
Marsi do ua shtojte edhe me tepër dëshirat seksuale gjate kësaj dite dhe ju do ndiheni sikur jeni mbi re ne krahët e partnerit. Ai do iu përgatisë surpriza te njëpasnjëshme ne mënyrë qe ju te ndiheni sa me mire te mundeni. Beqaret do kenë takime mjaft interesante, por do jene te pavendosur për te hedhur hapa me tej. Financat do i menaxhoni me shume kujdes dhe maturi.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
Do e përforconi lidhjen tuaj me partnerin sot dhe do mendoni për një te ardhme te largët me te. Tashme do jeni te sigurt se ai është personi i duhur për te kaluar jetën. Beqaret do tërheqin shume persona pas vetes dhe do bëjnë zgjedhjen e duhur. Financat do jene me te mira se kohet e fundit. Do keni mundësi edhe te shpenzoni, por edhe te hiqni disa para mënjane.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
Dite përgjithësisht e qete dhe pa emocione te veçanta kjo e sotmja për te dashuruarit. Merrni gjerat si t'iu vijjnë pa menduar për te nesërmen. Beqareve nuk do iu pëlqejnë aspak te flirtojnë me persona qe nuk i njohin dhe do mbeten serish vetëm. Ne planin financiar duhet te merrni te gjitha masat qe situata te mos behet problematike. Ju mundeni!

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
Mos e idealizoni me shume sesa duhet atë qe keni ne krah sepse mund t'i hipe vetja ne qejf dhe mund te shohë dike tjetër. Edhe komplimentet duhen bere me mençuri. Beqaret do bien me ne fund ne dashuri me personin qe iu përshtatet me tepër. Ne planin financiar nuk duhet te ndërmerrni shume rreziqe edhe sikur situata te jete e qëndrueshme.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
Do keni shume dyshime mbi partnerin tuaj sot dhe do debatoni gjate gjithë kohës me te. Do bënit mire te tregoheshit te kujdesshëm sepse një fjale me tepër dhe çdo gjë do marre fund. Beqaret do përfitojnë pafund nga liria qe kane dhe nuk do mendojnë aspak për dashurinë. Influenca e yjeve ne planin financiar do jete kontradiktore, por jo me probleme te mëdha.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
Marrëdhënia ne çift edhe për ju do jete e tensionuar dhe problematike. Nuk do bini dakord me partnerin për disa vendime qe duhet te merrni dhe asnjeri nuk do toleroje. Beqaret ka shume gjasa te fillojnë një lidhje, por për një arsye apo për një tjetër do e mbajnë atë te fshehte. Ne planin financiar duhet te vazhdoni t'i menaxhoni me kujdes te ardhurat.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
Do i kushtoni me shume rëndësi sot lidhjes qe keni krijuar dhe marrëdhënia me partnerin do jete e mrekullueshme. Secili prej jush do i japë shume dashuri dhe përkrahje tjetrit. Beqaret do i marrin gjerat me qetësi dhe nuk do e kërkojnë me ngulm një person ne krah. Financat do jene te mira, por po u treguar te pamatur dhe po shpenzuar kuturu do keni probleme.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
Harmonia do mbizotërojë gjate gjithë kësaj dite ne jetën tuaj ne çift. Do ndiheni me se miri ne krahët e atij qe dashuroni dhe nuk do keni asgjë për çfarë te qaheni. Beqaret nuk duhet ne asnjë mënyrë t'i mendojnë personat qe do takojnë si objekte sepse do zhgënjehen me vone. Ne planin financiar nuk duhet te kryeni transaksione te mëdha sepse nuk është ende koha e duhur.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
Fale mbështetjes qe do iu japë Urani, marrëdhënia juaj ne çift do jete me e bukur se disa dite me pare. Nuk do kërkon me te dominoni mbi tjetrin dhe do tregoheni me te kuptueshëm. Beqaret nuk duhet te nxitohen për asgjë edhe sikur te gjejnë personin e duhur. Ne planin financiar do kryeni transaksione te rëndësishme ne mënyrë qe ta stabilizoni sa me pare situatën.

Mensur Mamuti	AKTORJA JUGO-AFRIKANE-AMERIKANE, NE FOTO	AUTORIA DHE GAZETARJA ITALIANE, FALLAÇI	FUTBOLLISTI TAHITIAN, POROIA	H	RROBAQEPËS
SIT BARISHTORE			AKTOR AMERIKAN, ISH BURRI I AKT. NE FOTO (SHQ.)		
B					
IRINISË					
KRYEQYTETI I BOLIVISË					
ISH POLITIKANI TURK, ISMET					
KËNGËTARJA E DIKURSHME, NIMANI					FILM ME AKTOREN NE FOTO, "AVOKATI..."
TH		INTENSITETI QË ËSHTË LARG QENDRËS SË DIÇKAJE		IMPULSI QAJ TË VDEKURIN ME ZË, VAJTOJ	
EPOPE			LUAN DAKA		
			LIDHËZ SIÇ, SIKURSE		
E KAM RESË					AKOMA ENDE
					ITALIA
					KOHA
					POLITIKANIA SHQIPTARE, MAJLINDA
ART JAPONËZ ME PALOSJEN E LETRËS					BESNIK MUSTAJ
					PREMIER LEAGUE
RAPSODI NIKPRELAJ					PËR (LAT)
					AKTORI AMERIKAN, KERI
KOHA	STUHI, FURTUNË				AKTORJA AMERIKANE, KLOUZ
	POLITIKANI SHQIPTAR, ILIR				INSTRUMENT FRYMOR
QË I TAKONË MERITAT					GAOQ SPIRO
					RADIO TELEVISION ITALIAN
ERBIUM			SUEDIA	LËNDË PLASËSE, PLUHUR	
			PRISHTINA	DRITA BOSHNJAKU	
LLQJ, MARKË				KËNGËTARJA AMERIKANE, SAMER	RUMANIA
				ZERO	KALIUMI
MJESHTRIA E TËBERIT AKROBACI					



ZGJIDHJET: H, SHOSHIT, BARORE, RINOR, LA PAZ, INENI, ZANA, TH, I, I, EP, LD, RESOJ, ORIGAMI, BM, NIKOLLE, PRO, FURI, GLEN, MERITOR, GS, ER, S, BARUT, TIP, DONA, R, AKROBATIKA

Shumë i lehtë Sudokun mesatar

	5	4		9	7	3	6	
1	7			5			9	2
			2					
4					9			
5	6					3	1	
		2					4	
					5			
9	1			6		2	3	
	4	8	7	3		1	5	

		8			5	
4			3			7
	1			6	9	
		9	3		8	1
		9			2	
2	6	4	7			
	2	7			3	
9			6			8
		4			1	

Shumë i lehtë: 254197368, 176358492, 839246517, 481623975, 567489231, 392571684, 723915846, 915864723, 648732159. Mesatar: 678294513, 492531867, 315876492, 547923681, 839615274, 261487359, 126748935, 953162748, 784359126.

QYTEZA ITALIANE SHET SHTËPI PËR 1 EURO



Këshilli i qytetit italian San Pietro Patì vendosi të shesë shtëpi të vjetra të braktisura me një çmim prej një euro, për të ringjallur këtë vend të vendosur në rajonin kodrinor të Sicilisë. Për shkak të migrimit dhe plakjes, qyteti humbi një pjesë të madhe të popullsisë, kështu që ishte e nevojshme të ndërmerren masa urgjente dhe hapa për të parandaluar zhdukjen e

këtij qyteti. Ata që zgjedhin të blejnë një shtëpi do të duhet të rindërtojnë duke përdorur gurin tradicional, dru dhe terrakote për çati, dhe ndoshta të punësojnë muratorë lokalë. Ajo që e bën këtë vend tërheqës është se është vetëm 15 minuta larg plazhit dhe në fund të Parkut Kombëtar të Nebrodit, zonave të mbrojtura të liqeneve malore dhe pyjeve. Administrata

e qytetit tani do të vlerësojë se sa shtëpi do të ofrohen për shitje dhe do të kontaktojë pronarët. Pritet që shtëpitë e para do të jenë në shitje vitin e ardhshëm. Qytetarët e huaj janë gjithashtu të mirëpritur. San Pietro Patì kishte 4000 banorë 20 vjet më parë, ndërsa sot numri është zvogëluar në 3.000. Qyteti i takon rajonit ku ka një përqindje të lartë të të papunëve.



Sa para duhet t'i ketë dikush për të qenë i pasur

Bankierët kanë vendosur kufirin e pasurisë. Sipas Bloomberg, bankierët kanë thënë se nëse nuk ke të paktën 25 milionë dollarë për të investuar, nuk mund të quhesh dot i pasur. Me 25 milionë mund të flesh i qetë edhe nëse bursa ka luhetjete të papritura. Por, edhe pasuria ka nivelet e veta. Nëse kërkon të quhesh i pasur i klasit të parë, atëherë duhet të kesh gati për investime plot 200 milionë dollarë. Në vitin 1994, 3 milionë dollarë ishin të mjaftueshme për të qenë "super i pasur", por në vitin 2018 kjo shifër është rritur shumë. Sipas "Forbes", Bill Gates është personi më i pasur në Amerikë. Themeluesi i Microsoft-it ka një pasuri prej 89 miliardë dollarësh.

Flamuri i Kosovës "ngjitet" në majën më të lartë të Europës



Mali Elbrus është më i larti në Evropë. Ai ndodhet në malet kaukaze në Rusinë e largët. Alpinistja kosovare Arineta Mula bëhet shqiptarja e parë që ngjitet malin 5642 metër të lartë, në kushte të vështira atmosferike madje. Nga maja e lartë e malit ajo ka pozuar me flamurin e Kosovës si dhe me flamurin kuqez të Shqipërisë. Lajmin për suksesin e ka ndarë

vetë Arineta në rrjetet sociale. "Për Kosovën tonë", ishte dedikimi i Mulës. Ajo ka falënderuar edhe autoritetet shqiptare që i mundësuan pasaportën për të udhëtuar drejt Rusisë. "Kisha mundësi të tjera që më lehtësonin udhëtimin drejt Rusisë, por këmbëngula që të pres dhe të udhëtoj me pasaportën shqiptare", vijonte Arineta Mula në postimin e saj.

MACJA 9 KG FILLON DIETË ME MBIKËQYRJE TË VETERINERIT



Një mace shtatëvjeçare në komunën Karşıyaka në Izmir të Turqisë, peshon 19.2 kilogramë, dhe nga shkak i kësaj, ka nisur një program të humbjes së peshës, raporton Anadolu Agency. Departamenti i Veterinarisë në komunën Karshiyaka, bën të ditur se macja ishte ushqyer në rrugë, por pesha e madhe e saj i ka vështirësuar lëvizjen, për çka aktualisht ndodhet në poliklinikën Taypark. Tashmë maces i janë bërë testet themelore për kontroll të shëndetit, dhe ajo është përfshirë në një program të humbjes së peshës. Meqë stresi dhe mbipesha janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën, macja mbahet në një kafaz të dizajnuar posaçërisht për të, në mënyrë që të lëvizë normalisht. Falë programit, gjatë shtatë ditëve të para të trajtimit, ajo ka filluar të humbasë në peshë, ndërsa tek mjeku do të qëndrojë derisa të kthejë peshën normale.



KALENDARI HISTORIK 7 GUSHT

3761 BC - Epoka (fillimi) i kalendarit modern hebre (Kalendari Proleptik Julian).

1506 - Papa Julius II dhe Franca okupojnë Bolonjën.

1513 - Beteja e La Motës: Trupat spanjoll nën komandë të Ramón de Cardona mundin venedikasit.

1840 - Willem I jep dorëheqje si mbret i Holandës.

1870 - Leon Gambetta fluturon nëpër Paris me balonë.

1908 - Serbia dhe Mali i Zi nënshkruajnë pakt kundër Austro-Hungarisë.

1942 - SHBA dhe qeveria britanike shpallin themelimin e Kombeve të Bashkuara.

1950 - Forcat amerikane pushtojnë Korenë.

1971 - Hapet Disney World në Orlando.

1990 - Izraeli fillon shpërndarjen e maskave të gazit në mesin e banorëve.

2001 - Fillon sulmi amerikan ndaj Afganistanit me sulme ajrore.



A E DINI SE...



Një studim suedez në fund të vitit të kaluar tregoi se gratë që hanë më shumë se 45 gramë çokollata në javë kanë një shans 20% më pak të sulmit në zemër sesa ata që nuk hanë çokollatë.

Çokollata ul presionin e gjakut, kolesterolin dhe zvogëlon shanset e sëmundjeve kardiovaskulare.

Adhuresit e çokollatës janë më pak të stresuar se të tjerët, dhe një studim në SHBA në vitin 2010 thotë se ata kanë shumë më pak shanse të vuajnë nga depresioni.



BARSOLETA

ARSYETIMI I NXËNËSIT

Del gjyshi dhe e thërret Benin nga dritarja:

- Beni mor Beni, hajde futu shpejt në shpi se po kalon mësuesja jote e të shef duke luajtur, a i ke thënë që do mungojë se jam i sëmurë.

- Jo jo gjyshi, futu ti shpejt brenda se i kam thënë se më vdiq gjyshi.



THËNIA E DITËS



Tradicionalistët janë pesimistë për të ardhmen dhe optimistë për të shkuarën. (Lewis Mumford)